# GAZETA SHQIPTARE






Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7488 E mërkurë 4 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)





Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Taksë apo tarifë?

Në çdo vend të botës, pagesa në hyrje të çdo autostrade është tarifë për mirëmbajtjen ose shlyerjen e investimit për atë rrugë. Sapo del nga Tetova ... Vijon në faqen 20





Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

## Tri modele në gjashtë realitete politike

Detanta që po shfaqet në prag të samitit historik ndërmjet SHBA-ve, Koresë së Veriut dhe asaj të Jugut, krijimi i frymës pajtuese Serbi-Kosovë ... Vijon në faqen 21



Rama-opozitës: Rrugëhumbur pa atdhe që duan kaos

## Rruga e Kombit, sot gjyqi, prokuroria kërkon burg për 11 nga 23 kuksianët

Basha: Bllokoni rrugët kryesore. Pse plasi grushti mes Strazimirit dhe kryebashkiakut të Kamzës në mbledhjen e PD...

Nga INA ALLKANJARI

Nën akuzë si shkaktarë të dhunës në protestën e zhvilluar ditën e shtunë në Rrugën e Kombit, kundër tarifës së vendosur nga qeveria, 23 të arrestuarit do të njihen sot me masën e sigurisë. Seanca gjyqësore do të zhvillohet ... Në faqet 2-5

FLET KREU I AGJENCISE, JONIDA BAÇI: PLOTESONI DOKUMENTET PER TE MARRE KOMPENSIMIN

# DREJTORESHA E ATP: 4224 DOSJE PRONASH ME MANGESI

Si do të shpërndahet fondi i pronave për 10 mijë dosje. Kthimi dhe kompensimi, për vitet 1995-96 janë marrë në shqyrtim rreth 12 mijë kërkesa.



*(Në foto)* Drejtoresha e Agjencisë së Trajtimit të Pronave, Jonida Baçi

Në faqen 7

DHURATAT, 10 MIJE LEKE

## 34 nenet e Kodit të ri Etik, deputetit i ndalohet të pijë alkool e drogë në punë

Në faqen 6

AVOKATI: DO BEJME REKURS

## Tjetërsimi i pronave, Apeli lë në "Arrest shtëpie" kryebashkiakun. Frrokaj: Jam i pafajshëm

Në faqen 9

AMBULANCA SHETITESE

## Zëvendësministri i Shëndetësisë së Turqisë: Do trajtojmë falas një pjesë të grave me tumor

Në faqen 10

STATISTIKAT

## Përllogaritja e masës mesatare mujore urbane dhe rurale e pensioneve, sa janë shtuar në 7 vjet

Në faqen 10

FLET REDONA KOÇI



## Juristja seksi: Për çfarë i refuzova 10 mijë euro. Si i evitoj ngacmimet në punë

Suplement

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, vendimet nga vitit 2008 deri në vitin 2017

# Pronat që s'kanë marrë kompensimin, aplikimi për 3500 dosje

*Lista me përfituesit, 6 dokumentet që duhet të dorëzohen në Agjenci*

Nga ORNELA MANJANI

Pronarëve që u është zënë tona nga ndërtimet pa leje, dhe nuk kanë marrë ende kompensimin duhet të paraqiten në Agjencinë e Trajtimit të Pronave për të përfituar prej fondit prej 18.9 miliardë lekësh. Këto



para do t'i përfitojnë rreth 3500 pronarë në të gjithë vendin. "Bazuar në aplikimet e kryera në ATP deri më tani për këtë proces, rezulton se rreth 3'500 subjekte përfitues nuk janë paraqitur fare në ATP për të aplikuar me ... Në faqet 18-19

# RRUGA E KOMBIT
## TAKSA


Rruga e Kombit

Tubimi përpara Drejtorisë së Policisë, procedohen 15 qytetarë të tjerë

# Protesta, gjykata e Tiranës vendos sot fatin e 23 të arrestuarve

### Prokuroria kërkon 'Arrest me burg' për 11 të ndaluar

Ina Allkanjari

Nën akuzë si shkaktarë të dhunës në protestën e zhvilluar ditën e shtunë në Rrugën e Kombit, kundër tarifës së vendosur nga qeveria, 23 të arrestuarit do të njihen sot me masën e sigurisë. Seanca gjyqësore do të zhvillohet në gjykatën e Tiranës, ky është vendimi i marrë nga autoritetet pas një vendimmarrjeje të mëparshme që kishte shpallur gjykatën e Kukësit si vendin ku do të shqyrtohej seanca për të dyshuarit. Mësohet se shkak i këtij ndryshimi është bërë fakti se ambientet në gjykatën e Kukësit janë të pamjaftueshëm për të mbajtur njëkohësisht në të njëjtën sallë të 23 të ndaluarit. Nga ana tjetër, bëhet me dije se organi i akuzës ka dorëzuar në gjykatë kërkesën për caktimin e masës së sigurisë për të ndaluarit. Mësohet se prokuroria do të kërkojë arrest me burg për 11 prej tyre, ndërkohë që për pesë të tjerë do t'i parashtrohet gjykatës kërkesa për të vendosur masën e arrestit shtëpiak. Ndërsa për 7 të tjerët, duke ju referuar moshës dhe shkallës së rrezikshmërisë, gjykata mund të japë masën e detyrimit me paraqitje deri në mbyllje të hetimeve. Për të gjithë ata që kërkohet arresti pretendohet se ka prova që i implikojnë, siç janë videot, por edhe shkalla e dhunës e përdorur prej tyre. Gjithashtu, masë sigurie do të kërkohet në mungesë edhe për 13 persona të tjerë të shpallur në kërkim dhe që policia nuk ka mundur t'i arrestojë. Sakaq pritet që Gjykata e Tiranës të jetë e blinduar ditën e sotme. Burime nga policia thonë se do të ketë prani të shtuar të uniformave blu që të sigurohet mbarëvajtja e këtij procesi, për shkak se parashikohet një grumbullim në masë i familjarëve të të arrestuarve dhe të mbështetësve të tyre. Ndërkohë gjatë ditës së djeshme mbështetësit e të ndaluarve kanë vijuar protestën para Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Pas procedimit penal dy ditë më parë për 8 nga protestuesit në kryeqytet, ditën e djeshme ka nisur procedimi edhe për 15 qytetarë të tjerë. Sipas uniformave blu ata po protestojnë në mënyrë të paligjshme dhe kanë penguar qarkullimin e mjeteve transportit dhe kanë prishur rendin e qetësinë publike. "Më datë 02.04.2018 u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, për shtetasit U.L, B.C, G.GJ, A.T, A.T, U.TH, XH.A, B.GJ, S.T, D.C, Z.K, S.K,S.D, A.F, A.B, pasi në vazhdim, në rrugën "Sami Frashëri", në hyrjen e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, po protestojnë në mënyrë të paligjshme, kanë penguar qarkullimin e mjeteve transportit dhe kanë prishur rendin e qetësinë publike. Punohet për identifikimin e personave të tjerë pjesëmarrës. Nenet 262, 293 e 274 të Kodit Penal", - thuhet në njoftimin e policisë.



**PROCEDIMI**
Pas procedimit penal dy ditë më parë për 8 nga protestuesit në kryeqytet, ditën e djeshme ka nisur procedimi edhe për 15 qytetarë të tjerë. Sipas uniformave blu ata po protestojnë në mënyrë të paligjshme dhe kanë penguar qarkullimin e mjeteve transportit dhe kanë prishur rendin e qetësinë publike.

**PROKURORIA**
Bëhet e dije se prokuroria do të kërkojë arrest me burg për 11 prej të ndaluarve në protestën në Rrugën e Kombit, ndërkohë që për pesë të tjerë do t'i parashtrohet gjykatës kërkesa për të vendosur masën e arrestit shtëpiak. Ndërsa për 7 të tjerët, duke ju referuar moshës dhe shkallës së rrezikshmërisë, gjykata mund të japë masën e detyrimit me paraqitje deri në mbyllje të hetimeve. Për të gjithë ata që kërkohet arresti pretendohet se ka prova që i implikojnë, siç janë videot, por edhe shkalla e dhunës e përdorur prej tyre.



### PROTESTA

Prej ditësh, qytetarë të shumtë dhe anëtarë të shoqërisë civile janë të mbledhur përpara Drejtorisë së Policisë së Tiranës, duke protestuar dhe kërkuar lirimin e 23 të ndaluarve në protestën e dhunshme të datës 31 mars për taksën në Rrugën e Kombit. Përgjatë gjithë ditës së djeshme protestuesit kanë penguar qarkullimin e mjeteve transportit në zonën ku po zhvillohet tubimi. Qytetarë të shumtë dhe të afërm të personave të arrestuarve kanë kërkuar lirimin e tyre. 'Nuk jemi kriminelë, lironi të arrestuarit',-shprehen protestuesit. Disa prej qytetarëve iu drejtuan punonjësve të policisë, që këta të fundit të hiqnin uniformën dhe të bashkoheshin me ta në protestë. Protesta në kryeqytet nisi ditën e diel, rreth orës 19.00, ku dhjetëra qytetarë i bënin thirrje policisë dhe kryeministrit për të liruar të arrestuarit. Tensionet u përshkallëzuan kur qytetarët tentuan të futen në godinën e Drejtorisë së Policisë. Ndërsa kërkonin lirimin e 23 të arrestuarve, qytetarët protestuan me pankarta në dorë dhe me thirrjet 'Rama ik'. Kujtojmë se protesta nisi në datën 31 mars në Kukës, në shenjë kundërshtie për taksën prej 10 euro (vajtje-ardhje) që do të aplikohet në Rrugën e Kombit. Por gjatë protestës situata degjeneroi në konfrontime fizike me policinë. Banorë të shumtë kanë qëlluar me gurë mbi efektivët e policisë, ndërsa këta të fundit janë përgjigjur me shkopinj gome e dhunë. Më herët qytetarët janë shprehur se protesta fillimisht ishte e qetë, por ka qenë policia ajo që e tensionoi situatën. Protesta nisi në orën 11:00, ndërsa zgjati deri rreth orës 14:00. Qytetarë të shumtë bllokuan qarkullimin në të dyja anët e Rrugës së Kombit për rreth 3 orë. Fillimisht protestuesit u përleshën me forcat e policisë, ndërsa më pas, i vunë zjarrin sporteleve ku do të paguhej taksa. Në vendin e ngjarjes shkuan dhe forca zjarrfikëse për shuarjen e flakëve, por protestuesit nuk kanë lejuar të ndërhyjnë duke bllokuar kalimin. Ndërkohë policia u tërhoq në një distancë të konsiderueshme. Gjatë protestës qytetarët deklaruan se do të qëndronin 24 orë në rrugë deri në një reagim dhe tërheqje nga qeveria për taksën, por pas negociatave me policinë, në orën 14:00 protestuesit u tërhoqën. Nga protesta mbetën të plagosur disa qytetarë si dhe 12 punonjës të FNSH, një oficer i qarkullimit Adem Visha, dhe drejtori i policisë së Kukësit Perlat Vatoci.

**PROTESTUESIT**
Qytetarë të shumtë dhe të afërm të personave të arrestuarve kanë kërkuar lirimin e tyre. 'Nuk jemi kriminelë, lironi të arrestuarit',-shprehen protestuesit. Disa prej qytetarëve iu drejtuan punonjësve të policisë, që këta të fundit të hiqnin uniformën dhe të bashkoheshin me ta në protestë.

**EMRAT E PROTESTUESVE TË NDALUAR:**

- Rasim Koloshi, 23 vjeç, banues në Kukës.
- Rasim Onuzi, 38 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
- Florin Onuzi, 35 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
- Shaban Selmani, 60 vjeç, banues në Kukës.
- Zenel Matmuja, 48 vjeç, banues në Kukës.
- Adem Duraku, 59 vjeç, banues në fshatin Morinë, Kukës.
- Xhevahir Gashi, 33 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
- Armand Ademaj, 28 vjeç, banues në Kukës.
- Edmond Matmuja, 21 vjeç, banues në fshatin Pobreg, Kukës.
- Elton Cengu, 39 vjeç, banues në Kukës.
- Lefter Rexhmati, 38 vjeç, banues në fshatin Bushat, Kukës.
- Shpetim Toda, 44 vjeç, banues në Kolsh, Kukës.
- Xhevahir Hereni, 51 vjeç, banues në Kukës.
- Shemsi Trota, 54 vjeç, banues në Shtiqen, Kukës.
- Vasil Laçi, 31 vjeç, banues në Kukës.
- Lulëzim Uka, 33 vjeç, banues në Kukës.
- Ervis Oruçi, 25 vjeç, banues në Kukës.
- Ardit Alidini, 21 vjeç, banues në Kukës.
- Fatos Harulla, 33 vjeç, banues në Kukës.
- Sajmir Trota, 33 vjeç, banues në Kukës.
- Lulzim Popa, 60 vjeç, banues në Kukës.
- Shkelqim Vata, 42 vjeç, banues në Surroj, Kukës.
- Abdi Haziraj, 49 vjeç, banues në Kukës.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**,** ***Marketingu*****:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*****, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*****:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### ABONETË

Kontrata parashikon lehtësirat për banorët e zonës. "Për zbutjen e efekteve sociale do të jepen 120 mijë euro, plus vënia e një tarife që quhet abone. Mbase qeveria për shkaqe politike e ndjeshmërive të caktuara mund të kërkojë diçka më shumë dhe këtë risk nuk e merr kompania private, por qeveria", - tha Gjiknuri.



### EDHE 60 DITË

Për momentin ajo që dihet është se deri në rivënien e kabinave të pagesës, kalimi do të bëhet pa pagesë. "Nuk po paguhet, se u shkatërrua ajo pjesë. Do të ringrihet, do kohën e saj. Mbase do të dojë një periudhë 60-ditore minimalisht", - tha Gjiknuri. Dhënia me koncesion e rrugës është mundësi për ta përfunduar dhe për ta mirëmbajtur.



### SUBVENCIONI

Në dhjetë vitet e para pritet që të merren nga trafiku i garantuar mes 8.5-10 milionë euro në vit. Përveç këtyre të ardhurave, koncesionari do të marrë mesatarisht midis 1.5-1.7 milionë euro në vit nga buxheti për kompensim të trafikut të munguar. Pas vitit të dhjetë, pritet që të ardhurat vjetore nga trafiku i garantuar të rriten.



### DETYRIMET

Koncesionari do të jetë përgjegjës për ndërtimin e urës së re të Kukësit, deri në fund të vitit 3 të periudhës së koncesionit dhe për përgatitjen e projekteve përfundimtare të detajuara. Shpronësimi potencial i kërkuar deri në 3 hektarë tokë kërkon zhvendosjen e 5 familjeve.




Damian Gjiknuri: Ose do rrisnim taksat për të gjithë, ose do paguajnë ata që e përdorin

# Taksa në Rrugën e Kombit s'ka kthim pas

## *Ministri i Infrastrukturës: Taksa e Berishës, 8.5 euro*

Ornela Manjani

Zbatimi i taksës në Rrugën e Kombit s'ka më kthim pas. Do të duhen të paktën 60 ditë për rindërtimin e sporteleve ku do vilet taksa dhe më pas do të zbatohet. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri ka shpjeguar dje në një takim me gazetarët detajet e kontratës koncesionare për kalimin me pagesë në Rrugën e Kombit. Ai pohoi se ka një hendek financiar mes nevojës për mirëmbajtje që kanë rrugët dhe fondeve në dispozicion, ndaj u pa e nevojshme të merreshin masa. "Tarifa doli pas një studimi dhe përfshiu të gjithë elementët - tha ai. - Dy rrugë kishte, ose do të rrisnim të gjitha taksat e shqiptarëve që ta mirëmbajmë atë rrugë, ose do e paguajnë ata që e përdorin. Rruga është akoma e papërfunduar dhe ka shumë investime për t'u bërë". Gjiknuri ka folur edhe lidhur me protestat e disa ditëve më parë: "Dhuna dhe dëmtimi i stacioneve të pagesës u bë nga njerëz të motivuar politikisht. Po bëhet një vlerësim paraprak për dëmet në stacionin e pagesës. Dëmi shkon disa milionа euro. Ky investim nuk duhet ngatërruar me investimin privat, është pronë publike, investim që i takon shtetit shqiptar. Dëmi iu bë taksapaguesve dhe kapitalizohet në llogari të së gjithë kontratës". Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët u shpreh se qeveria shqiptare ka pasur një plan të studiuar për mirëmbajtjen e rrugëve në vend, që parashikonte pagesën e kalimit në disa prej akseve që në vitin 2008. Madje, sipas Gjiknurit, taksa e kalimit në Rrugën e Kombit është prezantuar që në 2016-ën, kur filluan punimet e mirëmbajtjes, por fillimisht është folur në 2011-ën nga qeveria "Berisha". "Dhe në parlament unë e anulova, se m'u duk e lartë. Si shpjegohet se ti këtë studim e ke miratuar me vendim qeverie dhe e ke shpallur për garë me tarifë 8.5 euro? Ky skenar i Berishës dështoi. Në 16 tetor 2013, me ardhjen e qeverisë sonë, ku ministër ishte Haxhinasto, IFC sugjeron të ndiqet skenari i parë nga një tender ndërkombëtar, ku u paraqitën dy oferta dhe u përzgjodh një ofertë fituese dhe kontrata u nënshkrua në 6 dhjetor të vitit 2016 nga ish-ministri Sokol Dervishaj. Tarifa e parashikuar në studim ishte 5.3 deri në 5.9 euro. Negociatat e çuan tarifën në vlerën 5 euro. Deri më tani - tha ministri - kompania ka bërë 15 mln euro investime mbrojtëse, investime për rikuperimin e tri skarpateve të dëmtuara dhe investime në tunel. E ar-dhura dysheme e koncesionit është 8 milionë euro, ndërsa e ardhura tavan 9.4 milionë euro". Lidhur me përdoruesit e rrugës, Gjiknuri tha se konsulenti IFC ka pohuar që tarifa 5 euro është e përballueshme. Gjiknuri shtoi se sipas Bankës Botërore, mirëmbajtja e 3900 km rrugë pa futur në punë rrugë të reja kërkon për 5 vite 320 milionë euro, llogaritur me një kosto mirëmbajtjeje sipas standardeve. "Taksat mbulojnë një pjesë të vogël për mirëmbajtjen, pjesa tjetër do të mbulohet nga taksapaguesit", tha ai.




Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri

### "Catalyst" u tërhoq nga koncesioni, shiti aksionet te "Kastrati" e "Salillari" për 200 mijë euro

Pak muaj pasi konsorciumi, bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Catalyst Viva Das General Constracting LLC & "Salillari" sh.p.k. & "BEE Tech" & "Violap Ateve" & "Kastrati" sh.a., përfaqësuar nga "Catalyst Viva Das General Constracting LLC" ka marrë koncesionin e Rrugës së Kombit, kompania përfaqësuese që kishte shumicën e aksioneve, "Catalyst" është tërhequr, duke shitur 40% të kuotave të saj te "Kastrati" dhe "Salillari". Edhe dy aksionerë të tjerë, "BEE Tech" dhe "Violap Ateve" me 10% janë tërhequr, duke e lënë të gjithë koncesionin në duart e "Kastratit" dhe "Salillarit", që tashmë zotërojnë nga 50% të aksioneve të konceisonit të Rrugës së Kombit.



**Shitje me Ankand te pare nga Studio Permbarimore L.D.C**

- ***Apartament" me nr. pasurie 1/1309+1-19, vol. 37, faqe 217, ZK. 8532, regjistruar ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Fier***. Me çmim shitje **36.000 Euro**

Data e shpalljes 15.03.2018
Data e zhvillimit 11.04.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambjentet e zyres Studio Permbarimore L.D.C te ndodhur ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8/1, Kati 1, Tirane, e-mail: erjon.papallazo@yahoo.com.

# RRUGA E KOMBIT
## REAGIMET



**PETRIT VASILI**
"Kryeministri të ikë, prokuroria të fillojë ndjekjen penale, pasi shkeli Kushtetutën për taksën e rrugës. Kushtetuta e Shqipërisë është e qartë si drita e diellit",-u shpreh dje, kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së. "Ky dhunues i Kushtetutës ia ka vënë në qafë taksën e Rrugës së Kombit njerëzve të thjeshtë pa ligj",-tha Vasili.



**ERMONELA FELAJ**
Deputetja e PS-së, Ermonela Felaj deklaroi dje, se aksioni i opozitës për mosbindje civile "është një çështje aq banale". "Basha është kreu i opozitës dhe bën thirrje të tilla!? Si bëhet buxheti i një vendi duke mos paguar taksa dhe takime? Po e bën për interesa të pushtetit të tij personal",-tha Felaj.

PS akuzon PD-LSI se po përdor taksën për të djegur rrugën europiane të vendit

# Rama-opozitës: Rrugëhumbur pa atdhe që duan kaos për t'i ikur drejtësisë

## *Balla: Basha në fund të karrierës, po dëmton Shqipërinë*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje, herët në mëngjes se PD kur ishte në qeveri e bëri tenderin e pagesës së rrugës 8-9 euro dhe dështoi. "Tani i vunë zjarrin "patriotik" e duan ta përdorin Kukësin si shishe benzine për të djegur rrugën europiane të Shqipërisë! Mjerë kush u beson rrugëhumburve pa atdhe që duan zjarr e kaos për t'i ikur drejtësisë!",-u shpreh dje, kryeministri Rama, në një status në rrjetin social, "Facebook". Ndërsa kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla e cilësoi të paligjshëm faktin që kryetari i PD-së, Lulzim Basha u bën thirrje qytetarëve për mosbindje civile. "Unë e kuptoj zotin Basha që po mundohet të gjejë çdo degë për t'u kapur në rënien e tij të lirë. Edhe kjo sjellje apo thirrje, e cila në çdo vlerësim ligjor është e paligjshme dhe bie në kundërshtim me rregullat bazë të funksionimit të shtetit dhe të sjelljes në një vend demokratik",-u shpreh Balla. "Është e paligjshme që një politikan i bën thirrje qytetarëve të mos paguajnë taksat, kur ndërkohë mbi bazën e tyre funksionon buxheti i shtetit, funksionojnë shkollat, funksionojnë qendrat shëndetësore, funksionojnë spitalet. Të thuash mos paguani taksat, do të thuash që të mbyllim spitalet, do të thuash që të mbyllim shkollat. Megjithatë, në papërgjegjshmërinë e vet të Lulzimit, që të gjithë e dimë se hall i madh e ka zënë, po të kemi parasysh disa fatalitete që e presin lidershipin e Partisë Demokratike në ditët dhe në javët në vijim, çështja e financimit rus, të gjithë e dimë se procesi i hetimit po ecën dhe Lulzim Basha nuk duhet të vonojë të japë dëshmitë e veta për këtë çështje", u shpreh Balla. Duke e lidhur me datën 17 prill, kur Komisioni Europian pritet të rekomandojë hapjen e negociatave me Shqipërinë, Balla tha: "Kjo është një përpjekje për t'u përdorur për qëllime politike. E ritheksoj, si sot dy javë Shqipëria ka momentin më të rëndësishëm të 10 viteve që kemi kaluar dhe të 10 viteve që vijnë. Kush tenton që për arsye të karrierës së vet politike, këtu e them shumë qartë për të gjithë shqiptarët: Lulzim Basha është në fund të karrierës së vet politike dhe si një i përfunduar në karrierën e vet politike po mundohet t'i bëjë dëm Shqipërisë". Balla kritikoi rolin e këshilltarëve socialistë të Bashkisë së Kukësit, për të sqaruar situatën dhe taksën, duke saktësuar se "Ky është një proces, i cili duhet të ishte bërë më mirë nga përfaqësuesit e Partisë Socialiste në Këshillin Bashkiak. Vendimmarrja jonë, ajo që bëri me dije kryeministri, do të kalojë në të gjithë procedurën që ka përcaktuar statuti i Partisë Socialiste".



Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla

**DEPUTETI I LSI**
Deputeti i LSI, Robert Bitri deklaroi se nuk ndan të njëjtin mendim për mosbindjen civile me kryetaren e partisë së tij, Monika Kryemadhi. "Zoti Basha nuk është kryetar i partisë time. Unë nuk ndaj të njëjtin mendim",-u përgjigj deputeti i LSI-së, i pyetur nga gazetarët për mosbindjen civile.




**PAULIN STERKAJ**
"Thirrja e Bashës është antikushtetuese. Tarifa 5 euro? Nuk jam ekonomist. Rruga duhet mirëmbajtur, por edhe banorët e Kukësit duhet të lehtësohen nga kjo tarifë. Thirrja për mosbindje civile bëhet për interesat personale",-u shpreh dje, deputeti i PS-së, Sterkaj.

### Kryeministri shqiptar ndërmjetësues tek Erdogan?

## Taksa e Rrugës së Kombit e gylenistët, takimi 1 orë i Ramës e Thaçit në Tiranë

Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi janë takuar në Tiranë në një vizitë jozyrtare. Takimi mes tyre është zhvilluar në një prej lokaleve të Tiranës dhe mësohet se në qendër të bisedës ka qenë më së shumti marrëdhënia e ndezur mes Prishtinës dhe Ankarasë. Por nuk përjashtohet edhe diskutimi për protestat që kanë plasur në Kukës për taksën e Rrugës së Kombit. Thaçi u takua për rreth një orë me Kryeministrin Edi Rama, i cili



thuhet se ka marrë përsipër të bëjë ndërmjetësin për rikuperimin dhe zgjidhjen e ngërçit të krijuar pas ndalimit dhe ekstradimit të disa qytetarëve turq në Kosovë, që akuzohen nga autoritetet turke si gylenistë, pjesë e rrjetit që organizoi grushtin e shtetit në Turqi. Thaçi ka marrëdhënie të mira me Presidentin turk Erdogan dhe si President i Kosovës i cilësoi personat e deportuar në Turqi si njerëz të përfshirë në aktivitete antiligjore, duke mbrojtur kështu dorëzimin e tyre pranë autoriteteve turke. Kundër këtij veprimi ka dalë hapur kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili shkarkoi ministrin e Brendshëm dhe kreun e Shërbimit Informativ, pasi nuk e kishin vënë atë në dijeni.




### Zv.kryeministrja, në aktivitetin "Drejt Samitit të BE-së"

## Podgoricë, Mesi në Konferencën Ballkanike: Meritojmë negociatat

Zv.kryeministrja, Senida Mesi mori pjesë në një konferencë të organizuar në Malin e Zi me temë "Drejt Samitit të BE-së për Ballkanin". Konferenca ishte një organizim i përbashkët i Partisë Socialiste Europiane, në bashkëpunim me Partinë Demokratike të Socialistëve të Malit të Zi dhe Partinë Socialiste të Shqipërisë. Gjatë fjalës së saj, zv.kryeministrja tha se Shqipëria meriton hapjen e negociatave. "Vendi ynë po ndërmerr reforma thelbësore, si ajo e reformës në drejtësi dhe reformës në administratën publike. Reformat, jo vetëm obligim për rrugëtimin tonë europian, por detyrim ndaj qytetarëve shqiptarë dhe brezave të ardhshëm. Nuk po kërkojmë një dhuratë nga BE - jemi të përkushtuar plotësisht në realizimin e reformave që kemi përpara dhe besojmë se kemi bërë progres të konsiderueshëm", deklaroi ajo. Konferenca zhvillohet me dy sesione dhe pas Podgoricës, do të ndalet në Tiranë ditën e mërkurë.




**VIDEOMESAZHI**

PD-ja publikoi shifrat se sa paguhet rruga në 7 vende të Europës, krahasuar me Shqipërinë. "Rama grabit shqiptarët për të pasuruar koncesionarët! Edi Rama u ka marrë shqiptarëve 800 milionë dollarë nga taksa e qarkullimit për mirëmbajtjen e rrugëve, por tani kërkon të na grabisë sërish me taksën e Rrugës së Kombit".



**JORIDA TABAKU**

Deputetja e PD-së reagoi dje nga Drejtoria e Policisë lidhur me deklaratën e ministrit Gjiknuri për mirëmbajtjen e rrugëve. "Kjo taksë është antikushtetuese dhe antiligjore. Qeveria duhet të mbrojë interesin e qytetarëve dhe jo koncesionarit. Ka ikur dita kur Rama do të vazhdojë të vjedhë qytetarët, të grabisë qytetarët", tha z.Tabaku.



**DRITAN DEMIRAJ**

Ish-ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj shkruan në "Facebook" se: "U nisa sot (dje) nga Troy, Michigan për në Miami, Florida dhe deri tek hoteli ku po pushoj sonte në Atlanta, Georgia. Bëra 1072 km në një superautostradë e gjitha e re dhe nuk pagova asnjë qindarkë. God bless America and albanian people!".



Mosbindja civile nis nesër, urdhri i kreut të PD: Bllokoni rrugët kryesore

# Basha, thirrje shqiptarëve: Mos paguani taksa, s'ju arrestojnë dot

## "Mblidhen 200 mln euro nga taksa e qarkullimit"

Valentina Madani

Mosbindja civile do të nisë nesër me bllokim rrugësh, për të vijuar me bllokim institucionesh dhe deri te bllokimi i punimeve të Kuvendit. Si shenja e parë e mosbindjes civile do të jetë bllokimi i akseve rrugore. Protesta do të shtrihet në të gjithë vendin, ndërsa pritet edhe bllokimi i disa akseve rrugore. PD do të bllokojë disa nga akset kryesore nacionale në Tiranë, Vorë, Lushnjë, Elbasan, Korçë, Lezhë etj. Kreu i opozitës mblodhi pasditen e djeshme deputetët dhe krerët lokalë të PD-së me të cilët diskutoi koordinimin e aksionit opozitar kundër qeverisë, konkretisht organizimin dhe përcaktimin e nyjave që do të bllokohen. Pjesa më e madhe e grupit parlamentar do të jetë me qytetarët në protestat që do të zhvillohen në këto akse. Ndërkohë mendohet që disa nga drejtuesit e grupit parlamentar do të jenë në parlament për t'i kërkuar qeverisë të reflektojë. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, apeloi sërish dje për mosbindje civile. Kreu demokrat në një dalje për mediat kërkoi nga qytetarët të mos paguajnë taksat e rritura, ndërsa i apeloi edhe Ramës lirimin e 23 protestuesve të arrestuar për dhunën në Rrugën e Kombit. Basha denoncoi se përmes taksës së qarkullimit shteti merr miliona euro, por këto para nuk përdoren për rrugët dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Sipas tij, shqiptarëve u mblidhen 200 mln euro në vit nga taksa e qarkullimit dhe asnjë cent nuk shkon për Rrugën e Kombit. "Mashtrimet e Ramës janë shenjat e dëshpërimit dhe panikut që e ka kapur. Rama i grabit dyfish shqiptarët dhe pastaj u bie dyfish me kërbaç. Reagimi i shqiptarëve në Kukës dhe në mbarë vendin është për situatën në të cilën ndodhen. Merr miliona euro nga taksa e qarkullimit, por nuk i përdor për rrugët. Dhe sot vendos një tjetër taksë për të kaluar rrugën. Ky është taksim i dyfishtë i shqiptarëve. Ata banorë në Kukës u ngritën për bukën e gojës, pasi e kanë të pamundur që të paguajnë taksë për të kaluar në Rrugën e Kombit. E bën këtë për të mbushur xhepat e oligarkëve. Paratë e shqiptarëve nuk u shërbejnë shqiptarëve, por i përdor për inceneratorët e Ahmetajt. Së dyti, ky është një reagim ndaj padrejtësisë së dyfishtë. Një javë i la kohë Rama me prokurorinë e tij Arbër Çekajt të arratisej, edhe pse kishte sjellë një sasi të madhe kokainë. Tahiri iu dha makinën e tij trafikantëve. Të lirë janë sot Habilajt, Balili dhe kriminelë të tjerë, ndërsa ata që protestuan për të drejtën e tyre, u arrestuan. Qytetarët që protestojnë kundër padrejtësisë terrorizohen që të mos reagojnë më. Ndaj jemi për mosbindje qytetare. Kjo është edhe një thirrje ndaj sipërmarrjes së vogël që të mos i paguajnë tarifat, pasi ato para nuk shkojnë tek qytetarët", tha kryedemokrati Basha. Kërkesa për mosbindje civile erdhi pas protestës së qytetarëve në Rrugën e Kombit, që kundërshtonin tarifën e vendosur nga koncesionari.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**AXHENDA**

Opozitarët nga nesër do të bllokojnë disa nga akset kryesore në vend si në Vorë, Fushë-Krujë, Bradashesh, aksi Lushnjë-Fier duke paralizuar kështu qarkullimin rrugor. Pjesa më e madhe e grupit parlamentar do të jetë me qytetarët në protestat që do të zhvillohen në këto akse. Disa nga drejtuesit e grupit parlamentar do të jenë në parlament për t'i kërkuar qeverisë të reflektojë.

## Mbledhja e PD, zbardhet incidenti mes Mziut e Strazimirit

Takimi organizativ mes deputetëve dhe kryetarëve të degëve të PD në Tiranë, për protestën që do të zhvillohet në akset kryesore të vendit ditën e enjte, dje u shoqërua me një incident të pakëndshëm. Mësohet se gjatë diskutimeve në lidhje me pjesëmarrjen e protestuesve në këto ditë përpara Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Tiranë, por edhe në protestat që do të zhvillohen të enjte, deputeti Gent Strazimiri dhe kryebashkiaku i Kamzës, Xhelal Mziu patën debate të forta, të cilat përfunduan deri në përplasje fizike. Burime brena mbledhjes me dyer të mbyllura shprehen se shkak për këtë përplasje mes Strazimirit dhe Mziut ishte pjesëmarrja e ulët e qytetarëve të Kamzës në këto organizime. Strazimiri dha udhëzime për mënyrën se si do të ndahen protestuesit në Vorë dhe Kamëz. Mziu shprehu pakënaqësi për shumë nga qëndrimet e mbajtura nga Strazimiri në mbledhje dhe debatoi ashpër me këtë të fundit, duke arritur deri në përplasje fizike. Përplasja mes deputetit demokrat dhe kryebashkiakut të Kamzës vijoi edhe jashtë selisë së PD, ndërkohë që ishin deputetët dhe krerët e degëve të PD ata që shuan konfliktin.

**BESNIK DUSHAJ**

Kryetari i Bashkisë së Tropojës, Besnik Dushaj, mbështet protestën e banorëve për heqjen e taksës në Rrugën e Kombit dhe kërkon lirimin e të arrestuarve. Ai tha se banorët e qarkut të Kukësit janë më të varfrit në Shqipëri dhe sipas tij, tarifat e larta të vendosura nga qeveria janë të papërballueshme.

## Berisha, Ramës: Prano kërkesat e opozitës, përndryshe të rrëzojmë

Ish-kryeministri Sali Berisha i bëri dje thirrje kryeministrit Rama që të pranojë kërkesën e opozitës për heqjen e taksave, në të kundërt shqiptarët do ta përmbysin nga pushteti. "Fake News/Një trillim i denjë vetëm për Ramën dhe papagajtë e tij! Të tromaksur nga revolta e qytetarëve të Kukësit, Hasit dhe Tropojës, jehona mbarëkombëtare dhe kombëtare e saj, Edi Rama ka mbushur poturet dhe kërkon të shpetojë duke veshur xhaketën time. Ai shpërndan në rrjetin e tij dhe nëpërmjet papagajve te tij lajmin e rremë se ai vendosi taksën në Rrugën e Kombit, pasi Berisha donte të vinte taksën 8.6 euro. Me këtë rast duhet t'i them se gënjeshtrat e tij bajate vetëm sa e akuzojnë më rëndë. Së pari, Berisha mund ta vendoste taksën së paku katër herë gjatë 3 viteve, nga 2010 deri në 2013, por ai vendosi që ajo taksë kurrë të mos vihej, përndryshe studimi që ai bëri do të shërbente vetëm për të gjetur mesataren që i duhej paguar koncesionarit nga taksa e qarkullimit për mirëmbajtjen e Rrugës se Kombit, dhe kjo mesatare rezultonte, siç deklaroi edhe ministri i tij në parlament, 2 deri në 5 euro", tha z.Berisha. Por sipas tij, kryeministri është i pashpresë. "Prano urgjentisht kërkesat e opozitës: Hiq me urgjencë 'taksën plaçkë' të Rrugës së Kombit, anulo menjëherë TVSH për biznesin e vogël, shtesën e tarifës së ujit, taksën e pronës, rikthe mbrojtjen ekonomike dhe ndihmën sociale për të mjerët që u preve kafshatën, përndryshe kjo pranverë do të jetë fundi yt i merituar. Revolta qytetare kundër taksave të larta do të përmbysë narkoshtetin tënd", shprehet z.Berisha.

Rregullat e reja të ligjvënësve: Të raportohen rastet e ngacmimeve seksuale në staf

# 34 nenet e Kodit të ri Etik, deputetit i ndalohet të pijë alkool e drogë në punë

## "Nuk lejohen dhuratat me vlerë më shumë se 10 mijë lekë"

Darina Tanushi

Deputetët pritet të miratojnë ditën e enjte në seancë plenare Kodin e ri të Etikës, edhe pse mendohet që kjo seancë do të jetë e nxehtë, për shkak edhe të zhvillimeve që kanë ardhur si pasojë e protestës për taksën e Rrugës së Kombit. Paraprakisht, opozita dhe mazhoranca kanë arritur të bien dakord për dokumentin që i është dërguar seancës për miratim. Në projektim prej 12 faqesh përcaktohen rregulla të qarta dhe të forta që nga veshja e deputetëve, sjellja me njëri-tjetrin, konflikti i interesit, moskonsumimi i lëndëve alkoolike e narkotike, apo edhe ngacmimet seksuale në mjediset e punës. "Deputetit i ndalohet të paraqitet në gjendje të mungesës ose të uljes së ndjeshme të ekuilibrit fizik dhe/mendor për shkak të konsumimit të alkoolit ose të substancave narkotike", - thuhet në një prej pikave të kodit të ri që është përfunduar pak ditë më parë, pikërisht më 28 mars. "Çdo deputet përpiqet të sigurojë dhe të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale. Ai reagon menjëherë, raporton, kërkon evidentimin dhe hetimin e rastit, kur merr dijeni të ndonjë pretendimi për ngacmim seksual, duke mundësuar që viktima e ngacmimit seksual të mos frikësohet, të mos denigrohet dhe të mos injorohet pretendimi i tij", - thuhet në projektvendimin e Kuvendit. Një nen tjetër tejet i rëndësishëm është ai që specifikon vlerën e dhuratave që duhet të pranojë një deputet, jo më shumë se 10 mijë lekë. "Deputeti nuk mund të kërkojë ose të marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë dhurata me vlerë mbi 10 mijë lekë, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij nga një individ, person fizik ose juridik privat", - thuhet në një tjetër pikë të kodit. "Deputeti, të cilit i janë ofruar dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet: a) t'i refuzojë ato dhe, në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, t'ia kthejë mbrapsht ofruesit ose në pamundësi, t'i dorëzojë zyrtarisht pranë shërbimit përgjegjës në Kuvend për administrimin e objekteve me vlerë, të cilat më pas përdoren për qëllime të veprimtarisë së institucionit". Në rast se ofrimi ose dhënia e të mirave të sipërpërmendura lidhen me kryerjen e një vepre penale, deputeti bën kallëzim pranë organit të ndjekjes penale, ndërsa dhuratat që kanë vlera artistike, muzeale ose historike administrohen në institucion dhe ekspozohen. Po ashtu, deputetëve u ndalohet të përdorin celularin në punimet parlamentare. Në fund të projektvendimit përcaktohet se "një vit nga përfundimi i mandatit, deputeti nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale konsulence ose kontratë pune biznesi ose individuale me Kuvendin ose të veprojë si avokat i paguar, palë kundërshtare, në çështje ku Kuvendi është palë".




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Aneks 2

PROJEKTVENDIM

PËR MIRATIMIN
E KODIT TË SJELLJES SË DEPUTETËVE TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës, neneve 40 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kodi i sjelljes së deputetit ka për qëllim:

Faksimile e kodit etik

**KONFLIKTI I INTERESIT**

Kur një deputet, gjatë procesit ligjvënës është subjekt i një interesi privat dhe mund të ndikohet nga çështja në shqyrtim, bën deklaratë me shkrim dhe e dorëzon pranë shërbimit përgjegjës për deputetët. Deklarata me shkrim e deputetit për konfliktin e interesit rast pas rasti publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

**MBARIMI I MANDATIT**

Një vit nga përfundimi i mandatit, deputeti nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale konsulence ose kontratë pune biznesi, ose individuale me Kuvendin, ose të veprojë si avokat i paguar, palë kundërshtare, në çështje ku Kuvendi është palë.

### DISA NGA PIKAT KRYESORE TË KODIT TË RI ETIK TË DEPUTETËVE

■ **GJUHA JOPARLAMENTARE DHE DISKRIMINUESE**

**1.** Përdorimi në Kuvend i gjuhës së pahijshme, fyese ose kërcënuese, ofendimet dhe sulmet fizike personale janë rreptësisht të ndaluara.

**2.** Deputetit i ndalohet:

**a)** Të përdorë një gjuhë të shprehuri, e cila nxit urrejtjen në bazë të racës, gjinisë, moshës, origjinës kombëtare, përkatësisë etnike, besimit fetar, prejardhjes sociale, aftësisë së kufizuar,
gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore ose shëndetësore, gjendjes civile, familjare ose martesore, orientimit seksual, identitetit gjinor, përgjegjësisë prindërore, predispozicionit gjenetik, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

b) Të shfaqë forma diskriminimi dhe stereotipizimi në komunikimin e përditshëm, në fjalime politike, në veprimtari parlamentare ose jashtëparlamentare ku merr pjesë.

■ **VOTIMI PËR TË TRETËT**

**1.** Gjatë votimit në Kuvend dhe në komisione, deputeti ndalohet të votojë në emër të një kolegu tjetër, i cili nuk është i pranishëm në sallë.

**2.** Deputeti që nuk është i pranishëm në procesin e votimit, ndalohet që t'i delegojë votën e tij një kolegu.

**2.** Deputetit i ndalohet:

**a)** Të paraqitet në gjendje të mungesës ose të uljes së ndjeshme të ekuilibrit fizik dhe/ose mendor për shkak të konsumimit të alkoolit dhe/ose të substancave narkotike ose psikotrope.

**b)** Të kryejë veprime të tjera ose gjestikulacione të pahijshme, përçmuese dhe ofenduese ndaj kolegëve, administratës së Kuvendit dhe të ftuarve, që ndikojnë negativisht në perceptimin e publikut për deputetin.

**3.** Gjatë veprimtarisë parlamentare, si rregull, deputeti nuk duhet të përdorë telefoninë e lëvizshme ose mjete të tjera, që tregojnë mungesë respekti ndaj kolegut, veprimtarisë parlamentare ose publikut dhe pengon mbarëvajtjen e punimeve parlamentare.

**4.** Kuvendi krijon mundësi për gruan deputete dhe staf i Kuvendit që kanë fëmijë të porsalindur, të marrë pjesë në punimet parlamentare bashkë me të. Kuvendi rishikon në mënyrë të vazhdueshme kushtet dhe kulturën e punës. Kuvendi siguron mundësi të barabarta për cilindo, si për deputetet, edhe për staf mbështetës.

■ **Ndalimi i ngacmimit seksual**

**1.** Deputetit i ndalohet çdo sjellje me natyrë seksuale që prek dinjitetin e cilitdo dhe që konsiderohet e padëshiruar, e papranueshme, e papërshtatshme dhe ofenduese për personin tjetër si dhe krijon një mjedis pune shqetësues, të paqëndrueshëm, armiqësor dhe frikësues. Për qëllim të këtij neni, sjellja e deputetit përfshin dhe nuk kufizohet në veprime fizike, fjalë, gjeste ose çdo lloj komunikimi virtual.

**2.** Çdo deputet përpiqet të sigurojë dhe të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale. Ai reagon menjëherë, raporton, kërkon evidentimin dhe hetimin e rastit, kur merr dijeni të ndonjë pretendimi për ngacmim seksual, duke mundësuar që viktima e ngacmimit seksual të mos frikësohet, të mos denigrohet dhe të mos injorohet pretendimi i tij.

■ **KONFLIKTI I INTERESIT**

Deputeti, kur ndodhet në një situatë konflikti interesi deklaron gojarisht në fillim të seancës plenare ose të mbledhjes së komisionit apo organeve të tjera parlamentare. Deklarimi regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes përkatëse. Kopje e procesverbalit i dorëzohet shërbimit përgjegjës për deputetët.

Kur një deputet gjatë procesit ligjvënës është subjekt i një interesi privat dhe mund të ndikohet nga çështja në shqyrtim, bën deklaratë me shkrim dhe e dorëzon pranë shërbimit përgjegjës për deputetët. Deklarata me shkrim e deputetit për konfliktin e interesit rast pas rasti publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një projektligj ose dokument tjetër politik kur ka konflikt interesi dhe as të promovojë projektligje ose interesa për shpërblim/pagesë apo për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta.

■ **DHURATAT DHE PËRFITIME TË TJERA TË NGJASHME**

1. Deputeti nuk mund të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë dhurata me vlerë mbi 10 mijë lekë, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat.

**2.** Dhuratat, favoret, premtimet ose trajtimet preferenciale të siguruara ose të ofruara për një deputet konsiderohen se i janë ofruar atij në lidhje me pozicionin e tij, përveç rasteve kur janë
përjashtuar në mënyrë specifike nga kriteret e parashikuara në pikën 6 të këtij neni.

**3.** Deputeti, të cilit i janë ofruar dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet:

**a)** t'i refuzojë ato dhe në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, t'ia kthejë mbrapsht ofruesit ose në pamundësi, t'i dorëzojë zyrtarisht pranë shërbimit përgjegjës në Kuvend për administrimin e objekteve me vlerë, të cilat më pas përdoren për qëllime të veprimtarisë së institucionit;

**b)** në rast se ofrimi ose dhënia e të mirave të sipërpërmendura lidhen me kryerjen e një vepre penale, deputeti bën kallëzim pranë organit të ndjekjes penale.

**4.** Dhuratat, që kanë vlera artistike, muzeale ose historike administrohen në institucion dhe ekspozohen.

**5.** Dhuratat që deputeti merr nga anëtarët e familjes (bashkëshorti/tja/bashkëjetuesi/sja, fëmijët e rritur, prindërit dhe të afërmit deri në shkallë të tretë) nuk konsiderohen si dhuratë në kuptimin e pikës 1 të këtij neni, përveç rasteve kur ato janë dhurata të ofruara në mënyrë indirekte nga dikush tjetër.

**6.** Dhuratat e zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratat me vlerë simbolike ose mirësjelljeje, brenda kufijve normalë të zakoneve tradicionale, të cilat nuk ngrenë dyshime lidhur me kryerjen e paanshme të detyrës nga ana e deputetit nuk duhet të konsiderohen si dhurata në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

**7.** Deputeti mund të pranojë dhurata nga institucionet homologe ose organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, ose protokollit, nëse nuk:

**a)** tejkalohen kufijtë e traditës dhe të zakoneve të vendit ku jepen;

**b)** vënë në dyshim objektivitetin dhe ndershmërinë e deputetit;

**c)** kompromentojnë imazhin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë.

Pas mbarimit të mandatit, deputeti nuk duhet ta përdorë për interes personal informacionin konfidencial të klasifikuar si të tillë, të marrë gjatë kryerjes së detyrës.

■ **KUFIZIM PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT**

**1.** Gjatë ushtrimit të funksionit, deputeti kryen detyrat e tij parlamentare pa u ndikuar nga mundësia e përftimit në karrierën e tij të ardhshme në sektorin privat, ose pa u ndikuar nga ish kolegët.

**2.** Një vit nga përfundimi i mandatit, deputeti nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale konsulence ose kontratë pune biznesi ose individuale me Kuvendin ose të veprojë si avokat i paguar, palë kundërshtare, në çështje ku Kuvendi është palë.

## Cipras: Zgjidhim problemet me Shqipërinë

Kryeministri grek, Aleksis Cipras është shprehur i gatshëm të zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet me Shqipërinë, pa cenuar interesat kombëtare të Greqisë. Gjatë mbledhjes së djeshme të qeverisë, Cipras u fokusua te politika e jashtme, duke theksuar se roli i Greqisë është stabiliteti në rajon. "Përpiqemi të zgjidhim mosmarrëveshjet me fqinjët, me Shqipërinë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë pa u tërhequr nga pozitat tona kombëtare dhe ndjenjat e përgjegjësisë kombëtare. Greqia si forcë stabiliteti dhe demokracie në rajon është protagoniste e kësaj përpjekjeje për të siguruar një mjedis të fqinjësinë së mirë bashkëpunimi dhe respektimi", tha Cipras. Kryeministri grek u ndal edhe te marrëdhëniet e tensionuara Greqi-Turqi, ku u shpreh se Greqia as nuk kërcënon dhe as nuk frikësohet nga asnjë. Gjithashtu, ai kërkoi bashkëpunimin e opozitës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me fqinjët në mbrojtje të interesave kombëtare. Në muajt në vijim pritet një vizitë e kryeministrit Cipras në Tiranë, me qëllim nënshkrimin e një pakti strategjik për bashkëpunimin dhe fqinjësinë të mire. Por mesa duket, Greqia nuk do të tolerojë asnjë pikë të bisedimeve.

### Kthimi dhe kompensimi, flet drejtoresha e Agjencisë së Trajtimit të Pronave

# Baçi: 4.224 dosje me mungesa, 6 muaj afat për plotësimin e tyre

## Për vitet 1995-96 janë marrë në shqyrtim rreth 12 mijë dosje

Ornela Manjani

Janë rreth 4224 pronarë që duhet të plotësojnë dokumentet për të marrë kompensimin për pronën e konfiskuar në vitin 1945. Në rast se përfituesit nuk dorëzojnë dokumentet në Agjencinë e Trajtimit të Pronave brenda gjashtë muajsh rrezikojnë që prona e tyre të trajtohet me vlerën minimale të hartës së vlerës. Lajmi u bë i ditur nga drejtoresha e Agjencisë së Trajtimit të Pronave, Jonida Baçi gjatë raportimit për vitin 2017 në Komisionin e Ligjeve. Sipas saj Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar vlerësimin financiar të 61% të dosjeve të pronarëve për kthim kompensim, ndërkohë që pjesa e mbetur do të përfundojë brenda vitit 2019. Drejtoresha e këtij institucioni Jonida Baçi ka raportuar të martën në Komisionin Parlamentar të Ligjeve, ku specifikoi se për vitet 1995-96 janë marrë në shqyrtim rreth 12 mijë dosje. 4.224 prej këtyre dosjeve janë ende pa vlerësim përfundimtar për shkak të mungesës së dokumentacionin përkatës. Ajo tha se pronarët kanë 6 muaj afat nga publikimi në regjistër për plotësimin e tyre, në të kundërt do të trajtohen me vlerën minimale të hartës së pronave. Baçi raportoi se në total janë mbyllur mbi 2500 dosje pronash për mungesë dokumentacioni dhe kalim të afatit të aplikimit.

**RAPORTIMI**

Drejtoresha e Agjencisë së Trajtimit të Pronave Jonida Baçi, e cila ka marrë detyrën në dhjetor të vitit të shkuar bën të ditur se janë trajtuar në total 61 % e pronarëve që presin kompensim. "Për vitin 2017 raportimin do ta ndaj në dy shtylla, raportim për procesin e punës për kompensimin, si dhe raportim për trajtimin e kërkesave për njohje së pronës dhe kompensimit të saj. Në procesin e kompensimit ATP kryen vlerësimin financiar dhe trajtimin e tyre, trajtimin me kërkesë të veçantë shpërndarjen e fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, praktikisht procesin e ALUIZNIt. Në këtë kuadër përgjatë vitit 2017 ATP-ja ka vijuar me vlerësimet financiare të vendimeve përfundimtare, të cilat kanë njohur të drejtën e pronës për vitet 95 dhe 96 në të gjithë republikën e Shqipërisë. Specifikisht kanë kaluar në procesin e verifikimit dhe vlerësimit 6941 vendime të vitit 1995 dhe 4877 vendime të vitit 1996 që kanë njohur të drejtën e pronës për kompensim ku, fakt, të vlerësuara financiarisht janë 6042 vendime me një vlerë financiare prej rreth 39 miliardë lekë, ndërsa për 4224 vendime nuk është bërë e mundur realizimi i vlerësimit financiar për shkak se nuk ka dokumentacion të plotë ligjor dhe hartografik që mundësojnë përcaktimin e zërit kadastral të origjinës"-tha Baçi. Sipas saj për këto vendime subjektet e interesuara mund të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit brenda një afati prej 6 muajsh nga data e publikimit të regjistrit. "Pas kalimit të këtij afati për depozitimin e dokumentacionit shtesë të nevojshëm për vlerësimin financiar në bazë të pikës 4, të nenit 16, të ligjit 133, të vitit 2015 këto vendime vlerësohen financiarisht me çmimin minimal të hartës së vlerës. Për 2017 janë rivlerësuar dhe publikuar 118 vendime për periudhën 93-94, të cilat i shtohen në total numrit të vendimeve të vlerësuara. Gjithashtu, bëj me dije se përgjatë procesit të vlerësimit të 1243 vendime rezultojnë të ezaurura ose kompensuara"-tha Baçi. Drejtoresha e ATP-së bëri të ditur para deputetëve se vendimet konsiderohen të kompensuara kur ka ndryshim të zërit kadastral origjinës së pronës dhe subjekti pa përfituar kthim fizik me vendimet e mëparshme dhe nga përllogaritjet sipas metodologjisë që përcaktohet në ligj rezulton se vlerësimi financiar i pronës është më i vogël se vlerësimi financiar pronës së kthyer. "ATP që prej fillimit të procesit ka verifikuar dhe vlerësuar gjithsej 15 856 vendime nga 26 mijë totale të deklaruara ose 61 % të dosjeve. Vetëm për janar-dhjetor 2017 janë vlerësuar 11 936 vendime. Në vitin 2017 buxheti i ka akorduar një fond prej 1.5 miliardë lekë, nga 3.3 miliardë lekë që parashikohej në ligj, këtij fondi i është shtuar fondi i mbartur i vitit 2016, 1. 4 miliardë ku në total fondi i kompensimit për ATP është 2. 54 miliardë lekë. ATP ka ekzekutuar 183 kërkesa nga 887 kërkesa të administruara pranë saj. Më specifikisht 145 kërkesa kanë përfituar vetëm kompensim financiar në vlerën rreth 1 miliardë lekë, 15 kërkesa kanë përfituar kompensim financiar dhe fizik, 7 kërkesa vetëm kompensim fizik rreth 5.6 ha. ATP kryen edhe një procedurë tjetër kompensimi atë të trajnimit me kërkesë të veçantë që do të thotë kompensim progresiv. Kjo procedurë është lehtësuese për pronarët që kanë një vendim dhe marrin kompensim jashtë radhës kronologjike, duke përfituar trajtim të menjëhershëm. Për 2017 janë paraqitur 53 aplikime dhe janë ekzekutuar 12 kërkesa"-mbylli fjalën e saj drejtoresha e ATP-së.



Drejtoresha e Agjencisë së Trajtimit të Pronave, Jonida Baçi

**39**

**MLD LEKË**

Janë 6042 vendime me një vlerë financiare prej rreth 39 miliardë lekë, ndërsa 4224 vendime nuk është bërë e mundur realizimi i vlerësimit financiar për shkak se nuk ka dokumentacion të plotë ligjor dhe hartografik që mundësojnë përcaktimin e zërit kadastral të origjinës.

**FONDET PËR 2017**

Në vitin 2017 buxheti i ka akorduar një fond prej 1.5 miliardë lekë nga 3.3 miliardë lekë që parashikohej në ligj, këtij fondi i është shtuar fondi i mbartur i vitit 2016, 1.4 miliardë ku në total fondi i kompensimit për ATP është 2.54 miliardë lekë.



### Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inspektim në dogana

# Qafë Thanë / Kërkohet fond i posaçëm për investime në doganë

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato ka zhvilluar këtë të martë një takim pune në pikën e kalimit kufitar të Qafë Thanës. Ajo u shoqërua në këtë takim nga prefekti i Korçës Dhori Spirollari. Fillimisht ministrja Qato u ndal në pikën e skanimit të automjeteve që hyjnë dhe dalin nga kufiri shqiptar drejt Maqedonisë dhe anasjelltas. Njëkohësisht ajo ka ndjekur nga afër edhe mënyrën e procesimit në skaner të automjeteve, ndërkohë që më pas zhvilloi inspektime edhe në sektorë të tjerë të doganës, ku u njoh nga afër me punën që bëhet aty. Në takimin që pati me drejtorin e doganës së Qafë Thanës, ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato u njoh me disa nga problematikat që ekzistojnë në këtë doganë, që nga borxhi i akumuluar ndër vite dhe që mbetet për t'u mbledhur dhe deri tek ambientet e doganës, të cilat prej vitesh nuk kanë marrë asnjë investim në drejtim të infrastrukturës. Për këtë arsye drejtuesit e doganës i kanë kërkuar ministres që të vendoset një fond i posaçëm për të investuar në portën hyrëse në Maqedoni. Nga ana e saj, ministrja deklaroi se një nga arsyet e kësaj vizite ishte për të parë nga afër nevojat që kanë ambientet dhe zyrat për investim. "Është edhe një inspektim i zyrave shtetërore, punës së administratës, kushteve në të cilat punojnë, ambientet fizike të tyre"- tha ministrja Qato. Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes më pas ka vijuar me disa vizita në bizneset e zonës së Pogradecit.

**INVESTIMI**

Ministrja deklaroi se një nga arsyet e kësaj vizite ishte për të parë nga afër nevojat që kanë ambientet dhe zyrat për investim. "Është edhe një inspektim i zyrave shtetërore, punës së administratës, kushteve në të cilat punojnë, ambientet fizike të tyre"- tha ministrja Qato




Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato

### Ish-Prokurori i Përgjithshëm u dorëhoq nga sistemi i drejtësisë

# KPK ndërpreu vetingun për Llallën, Kolegji i Apelimit regjistron çështjen


Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla

Procesi i vetingut ndaj ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla, i cili u ndërpre më herët nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pasi ky i fundit u dorëhoq nga e drejta për t'u emëruar gjyqtar apeli dhe rrjedhimisht nga i gjithë sistemi i drejtësisë, pritet të rinisë. Kolegji i Posaçëm Apelimit ka marrë në shqyrtim çështjen e dorëzuar nga Komisioneri Publik, ku kërkohet që ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla t'i nënshtrohet vetingut, deklaron Top Channel. Verdikti për ndërprerjen e vetingut u mor në atë kohë nga trupi gjykues i KPK me kryesues Roland Ilia dhe anëtarët Pamela Qirko dhe Olsi Komçi. Por, ky është rezultat i njëjtë sikurse edhe ai i një trupe tjetër gjyqësore të KPK, e cila po për shkak të dorëheqjes si gjyqtar kushtetues i ndërpreu vetingun edhe Besnik Imerajt. Dosjet e të dorëhequrve dhe të të papërshtatshmëve arkivohen, por, nëse kërkohen nga prokuroria, atëherë ata i nënshtrohen edhe kontrollit penal. Largimi i Llallës nga drejtësia solli menjëherë reagimin e ambasadorit amerikan, i cili në një postim në Twitter kujtonte se askush nuk mund t'i shpëtonte drejtësisë. Ndërkohë Departamenti Amerikan i Shtetit i ka ndaluar hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla. Vendimi është publikuar në faqen zyrtare të DASH, ndërsa masa e ndalimit është miratuar nga Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson, pasi ish-zyrtari i lartë i organit të akuzës në Shqipëri akuzohet për përfshirje në raste të mëdha korrupsioni. Sakaq disa ditë më parë media gjermane DW, deklaroi se drejtësia po tregon se po vepron në bazë të provave dhe fakteve dhe rasti më domethënës është ai i ish- Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Llalla. "Hetimi ndaj ish-Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla është një sinjal se për kulturën e pandëshkueshmërisë, të betonizuar në Shqipëri prej më shumë se dy dekadash, po fillon procesi i çmontimit",-shkruante Deutsche Welle.

**VETINGU**
Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka marrë në shqyrtim çështjen e dorëzuar nga Komisioneri Publik, ku kërkohet që ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla t'i nënshtrohet vetingut. Ky proces u ndërpre më herët nga KPK pasi Llalla u dorëhoq nga e drejta për t'u emëruar gjyqtar Apeli.

### Pashke Gjoka: Tentova të hipja në makinën ku futën mallin që e mora me lekë borxh, por më shtynë në tokë

# Shiste qirinj afër kishës, 58-vjeçarja përfundon në spital

## "Policia Bashkiake e Laçit më dhunoi, rashë pa ndjenja në tokë"

**KURBIN**

Një 58-vjeçare që banon në afërsi të Kishës së Shna Ndout në Laç ka përfunduar në spital për shkak të dhunës së ushtruar nga Policia Bashkiake e këtij qyteti. Bëhet fjalë për Pashke Gjokën, e cila ishte duke shitur qirinj anës rrugës për të fituar bukën e gojës. Mësohet se gruas i është sekuestruar i gjithë malli, ndërsa gjatë momentit që ajo ka bërë rezistencë, policët e kanë shtyrë dhe ajo ka rënë pa ndjenja në tokë. 58-vjeçarja është dërguar në spitalin e Laçit për të marrë ndihmë mjekësore. Nga shtrati i spitalit, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Pashke Gjoka tha se tentoi të hipte në furgonin e policisë bashkë me mallin, të cilin e kishte marrë borxh dhe nuk donte ta humbte, por policët e kanë shtyrë e dhunuar. "Kam qenë tek kisha duke shitur qirinj si gjithë të tjerët. Erdhi policia dhe na tha që të largoheshim. Ne nuk u larguam, dhe unë si gjithë të tjerët. Ndonëse, unë isha më e pambundur se të tjerët. Policët më morën arkën e qirinjve dhe më thanë: Këto po i marrim ne dhe ti nuk ke për të shitur më këtu. Ndërsa, unë u thashë që të mos më merrnin arkën me qirinjtë, pasi i kisha marrë borxh dhe nuk i kam paguar lekët. U thashë që të më merrnin dhe mua bashkë me qirinjtë. Shkova të hyj në makinën ku futën qirinjtë, por policët nuk më lanë. Ata më thanë se kjo makinë nuk është për transport njerëzish, por për mall. Policët më shtynë me forcë dhe rashë pa ndjenja. Vetëm kur e pashë veten në spital. Më shtynë që të mos hipja në makinë",-u shpreh Pashke Gjoka. Ndërkaq, ajo pohoi se kishte dalë për të shitur qirinj, pasi të gjithë familjarët e saj janë të papunë. "Unë paguaj për çdo muaj 139 mijë lekë për kredinë. Shtëpinë e kam afër kishës, ndaj shes qirinj atje për besimtarët që vijnë në vendin e shenjtë. Unë kam kërkuar të më punësojnë tek kisha, pasi kam shkollë si të tjerët, por nuk më kanë pranuar. Nuk kam me se të siguroj të ardhura për familjen time. Policia jo vetëm që më mori mallin që e kam marrë me lekë borxh, por edhe më dhunoi. Kjo është e padrejtë. Unë isha e gatshme të më dërgonin ku të çonin qirinjtë",-u shpreh 58-vjeçarja. Ndërkaq, djali i saj pohoi: "Ne jemi të gjithë të papunë. Nuk marrim as asistencë. Nënën e çuam në punë, por përfundoi në spital për shkak të dhunës së policisë".


Pashke Gjoka duke folur për "GSH"

**DJALI I FAMILJES GJOKA**
Dhuna e ushtruar ndaj 58-vjeçares Pashke Gjoka nga Policia Bashkiake e qytetit të Laçit ka tronditur familjarët e saj. Djali i të moshuarës u shpreh për "Gazeta Shqiptare" se "Ne jemi të gjithë të papunë. Nuk marrim as asistencë. Nënën e çuam në punë, por përfundoi në spital për shkak të dhunës së policisë".


United Nations Development Programme

UN DP
Empowered lives. Resilient nations.

**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject: – the "RFP for Develop a web CMS network – multi-site for Municipalities of Albania" for STAR 2 Project**

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 45258 RFP for ""RFP for Develop a web CMS network – multi-site for Municipalities of Albania" for STAR 2 Project**

**For more details please refer to the link below:**
http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/

**Relevant dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 24-Apr-18

**Address for communications:**
Email: procurement.al@undp.org
**Or**
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania


### SHKRUMBOHET MAGAZINA, DYSHOHET ZJARRVËNIE E QËLLIMSHME




**Pas përfshirjes nga flakët mbrëmjen e së hënës, magazina me materiale elektrike në rrugën 'Siri Kodra' në kryeqytet, duket se është shkrumbuar totalisht. Forcat zjarrfikëse arritën të shuajnë zjarrin në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Fatmirësisht nuk pati të lënduar, por vetëm dëme materiale. Ndërkohë policia dyshon se në sektorin e abazhurëve brenda kësaj magazine, një person ka vendosur qëllimisht zjarrin, për të dëmtuar këtë biznes. Sakaq vijojnë hetimet dhe për këtë arsyeje janë sekuestruar disa kamera sigurie në zonë, për zbardhjen e kësaj ngjarje.**

## Konflikti mes viktimës e agresorit, për motive pronësie

# Vret me automatik ish-kryetarin e fshatit, arrestohet autori

**SKRAPAR** - Konfliktet për pronën i kanë marrë jetën ish-kryetarit të fshatit Rehovë në Skrapar. 60-vjeçari Jonuz Banaj u qëllua për vdekje me automatik nga bashkëfshatari i tij, Fatmir Cenaj. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Beratit bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës


Autori i vrasjes, Fatmir Cenaj gjatë arrestimit

09:40 të ditës së djeshme. Mësohet se mes Banajt dhe 58-vjeçarit Fatmir Cenaj ka pasur vazhdimisht një konflikt për motive pronësie. Ndërkaq, mëngjesin e djeshëm, Cenaj dhe ish-kryeplaku kanë shkëmbyer fyerje dhe sharje të rënda mes tyre. Pas debatit, autori i krimit ka marrë automatikun në banesën e tij dhe ka qëlluar mbi 60-vjeçarin. Për pasojë, ky i fundit mori një plagë në qafë, ndërsa bashkëshortja e tij (ish-infermiere) u përpoq t'i ndalonte gjakderdhjen, por pa ia arritur qëllimit. I plagosuri u transportua me helikopter në Spitalin Ushtarak Tiranë për ndihmë mjekësore më të specializuar, por nuk mundi t'u mbijetonte plagëve të marra. Menjëherë pas ngjarjes, blutë bënë arrestimin në kohë rekord të autorit të vrasjes, i cili ishte fshehur në kodrat e fshatit. Ndërsa, u sekuestrua në cilësinë e provës materiale edhe arma e krimit tip automatik model 56. Materialet në ngarkim të Fatmir Cenajt i kaluan për hetime të mëtejshme prokurorisë së Beratit për veprat penale "Vrasje me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje".

## Avokati i kreut të bashkisë, Neshat Fana: Do bëjmë rekurs në Gjykatën e Lartë

# Tjetërsimi i pronave, Gjykata e Apelit lë në 'Arrest shtëpie' kryebashkiakun e Lezhës

## Fran Frrokaj: E ndjej veten totalisht të pafajshëm

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**

Tre zyrtarë të lartë të Lezhës kanë mbetur sërish nën masën "Arrest shtëpie", por me ndryshimin e vetëm pa mbikëqyrje policore, ndërsa është hequr edhe masa e moskomunikimit. Gjykata e Apelit në Shkodër dje la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Lezhës ndaj kryetarit të Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj; kryetarin e Këshillit të Qarkut, Gjokë Ndoka, nënkryetarit të Bashkisë Lezhë, Enver Hafizi si dhe 4 zyrtarëve të tjerë dhe një përfituesi. Këta shtetas akuzohen nga prokuroria për veprat penale: "Shpërdorim detyre" dhe "Falsifikim dokumentacioni". Gjatë seancës së djeshme gjyqësore, prokuroria kërkoi masën e sigurisë "arrest me burg", ndërkohë që gjykata e rrëzoi këtë kërkesë. Nga ana tjetër pala mbrojtëse për 7 zyrtarët kërkoi masën lehtësuese "Detyrim paraqitje", por Gjykata e Apelit Shkodër i la në "Arrest shtëpie". Pas dhënies së vendimit ka reaguar, kryebashkiaku Frrokaj, i cili e quajti një hap para drejt drejtësisë. Ai mohoi kategorikisht akuzat, ndërsa deklaroi se është totalisht i pafajshëm dhe se nuk ka asnjë përgjegjësi penale për tjetërsimin e 234 mijë metrave katrorë tokë në zonën e "Ranës së Hedhun" në Shëngjin.

**KRYEBASHKIAKU**

Fran Frrokaj, i cili ishte i pranishëm në seancën gjyqësore të zhvilluar dje në Shkodër u shpreh i zhgënjyer me vendimin e Gjykatës së Apelit, që e la në "Arrest shtëpie". "Nuk do të shprehem, drejtësia të veprojë. Mendoj që do të jenë më të drejta. Vendimi i sotëm (djeshëm) është një hap përpara drejt lirisë, drejtësisë. Por, besoj se drejtësia e plotë do të gjendet në shkallë të tjera. Pasi të plotësohen hetimet për të cilat unë jam që të plotësohen. Jo, nuk do shprehem në këtë drejtim për një sulm politik apo jo, të mbarojnë provat dhe në fund fare do të flas. Nuk kam asnjë lloj përgjegjësie në këtë proces, absolutisht do të vazhdoj të kërkoj pafajësinë deri në fund", tha kryebashkiaku i Lezhës. Gjithashtu, ai pohoi: "E ndjej veten totalisht të pafajshëm. Sot (dje) kërkova ndryshim të masës së sigurisë, sepse nuk jemi në gjykim me themel për të kërkuar pafajësi. ATMP (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi vjen i plotësuar dhe nuk plotësohet asnjëherë nga bashkia. Jemi thjesht institucion i ndërmjetëm në këtë rast. ATMP ne e marrim si të ligjshme dhe të rregullt dhe kalon tek ne më shumë për vjeljen e taksës se sa për verifikim. Këtë nuk e bëjmë ne. Qytetari që ka këtë dokument, bashkia s'ka të drejtë firme. Thjesht ne i përcjellim në hipotekë. ATMP firmos 20 deri në 50 akte në ditë dhe s'kemi mundësi të shkojmë në terren dhe nuk kam kompetencë. Nëse dikush ka parë që dokumentet janë false, atëherë mund t'i dërgojë tek komisioni i dokumentacionit. Mbiemri Frrokaj s'ka lidhje me mbiemrin Frroku, janë krejt të ndryshëm. Asnjë nga fisi im s'ka lidhje në 10 breza me këto persona. Dokumentacioni i ATMP përsa i përket hartografisë verifikohet nga Këshilli i Qarkut dhe hartograf privat me licencë. Kam ngelur i ofenduar nga prokuroria. Të paktën një herë do të duhej të isha thirrur, sepse jam i komunikueshëm". Kurse sipas prokurorisë, Fran Frrokaj ka firmosur dokumente pa ia kaluar ZRPP, ndërsa dyshon se kryebashkiaku ka kryer veprën penale të "shpërdorimit të detyrës" bashkë me vartësit e tij.

**MBROJTJA**

Neshat Fana, avokati i kryebashkiakut Fran Frrokaj deklaroi dje se do të bëjë rekurs në Gjykatën e Lartë për të kërkuar heqjen e masës "Arrest shtëpie" për klientin e tij. "Kontestoj qëndrimin e prokurorit, sepse tha gjëra të pavërteta dhe përdori gjuhë joligjore. Përdorimi i zhargonit mediatik nga prokurori është i papërshtatshëm. Vendimi është i pabazuar dhe në tejkalim të kufijve kufizues. Frrokaj nuk ka pasur dijeni, sepse persona tjerë përpilojnë dokumentacionin. Vepra penale falsifikimit kryhet me dashje dhe Frrokaj nuk ka pasur asnjë dijeni, sepse kanë qenë me firma dhe vula të institucioneve të tjera. Është absurd pretendimi. Falsifikatorët të mbajnë përgjegjësi, por Frrokaj nuk ka pasur dijeni dhe askush edhe në shkallë të parë nuk ka thënë një gjë të tillë. Edhe sikur bashkia të gabonte, ZRPP mund të frenonte dhe ndalonte veprimet e tjera, sepse ia jep ligji këtë të drejtë. Kërkojmë ndryshim vendimi dhe të jepet masë lehtësuese për Frrokajn, detyrim paraqitje ose garanci pasurore. Ne do të bëjmë rekurs në Gjykatën e Lartë. Prokuroria kërkoi rikthimin në burg, gjë e cila është e paligjshme", tha Fana. Ndërsa Genc Gjokutaj, avokat i kreut të Këshillit të Qarkut Lezhë, Gjokë Ndoka pohoi se është një proces skandaloz nga pikëpamja ligjore, sepse të dyshuarit s'janë thirrur asnjëherë nga prokuroria dhe kërkohet që përmes të arrestuarve të cilësohet si një bandë me një dashakeqësi nga organi i akuzës.

**TJETËRSIMI I PRONAVE**

Më 16 mars të këtij viti, policia e Lezhës finalizoi operacionin e koduar "Ranishtja 4" me arrestimin dhe ndalimin e 12 zyrtarëve publikë, ndërsa shpalli në kërkim 11 persona të tjerë. Sipas policisë, këta persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin duke abuzuar me detyrën kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 234,548 m2 tokë shtetërore ranishte në zonën bregdetare Shëngjin, tek vendi i quajtur "Rana e Hedhun". Aktualisht, të vetmit që ndodhen në qeli janë juristi i bashkisë, Ardenis Haxhia dhe Enkelejd Zefi, specialist hartograf pranë Hipotekës së Lezhës.


Gjyqi i djeshëm në Apelin e Shkodrës

**VENDIMI PER ZYRTARËT E TJERË**

Gjykata e Apelit Shkodër dje la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Lezhës dhe për Gjelina Bacaj, drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Lezhë; Adenis Haxhia, jurist i bashkisë; Enkelejd Zefi specialist pranë ZVRPP; Dilaver Neli, specialist në Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës të Këshilli Qarkut Lezhë dhe Pjetër Gjoni, përfitues i tokës.

## SHKURT

### Trafiku i kokainës, ja kodet që përdorte "kasapi" shqiptar

**ITALI** - Një 33-vjeçar shqiptar u arrestua nga karabinierët e Albenga-s, në bashkëpunim me policinë kufitare sapo ai zbriti në aeroportin e Xhenovas. Mësohet se shqiptari ishte shpallur në kërkim për trafik droge, pasi e kishte shndërruar thertoren e tij si mbulim për aktivitetin e paligjshëm, ndërsa bashkëpunonte me dy shqiptarë të tjerë, një 25-vjeçar dhe një 28-vjeçar. "Liguria notizie" shkruan se pas hetimeve rezultoi se shqiptari kishte investuar para të mbledhura nga droga për të blerë makina, të cilat më pas i shiste në Shqipëri. Operacioni "Tender meat" u mbyll me arrestimin e 14 personave. Gjatë kontrollit, shqiptarit iu gjetën 1 kg kokainë dhe 16 kg marijuanë si dhe 39.500 euro. Nga hetimet u zbuluan edhe kodet që përdorte banda, teksa bënte porositë për marijuanën dhe kokainën si: bifteku "fiorentin", "brinjë" dhe "fileto". Sipas policisë, biznesi i 'mishit' i sillte bandës rreth 50 mijë euro të ardhura në javë.

### Shkatërrohet banda e kokainës në Athinë, kapen 5 shqiptarë

**GREQI** - Një grup i shpërndarjes së kokainës është shkatërruar nga policia greke në Athinë. Në pranga kanë përfunduar 5 shqiptarë që vepronin në zonat e Neas, Smirnit, Kalitheas dhe Larisas. Shqiptarët e arrestuar janë të moshës 31-35 vjeç. Ndërsa janë shpallur në kërkim edhe dy shqiptarë të tjerë. Në mesin e të ndaluarve është edhe një femër. Nga ky operacion u sekuestruan 436 gr kokainë, 300 gr përzierës, 2000 euro, 3 peshore, 2 pistoleta, 2 makina, 14 celulare. Udhëheqësi i bandës ishte një 34-vjeçar, identiteti i të cilit nuk bëhet i ditur. Ai ishte përgjegjës për gjetjen e sasive të kokainës dhe drejtonte anëtarët e tjerë, në mënyrë që droga të ruhej në vende të përshtatshme.

STRATI Bailiff Service

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-"Pyll", me sipërfaqe **6000 m2**, ndodhur në **Qerret, Kavajë**, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumi 21, faqe 82, rregjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është **15,120,000 Lekë**;

- "Pyll" , me sipërfaqe **1000 m2** , ndodhur në **Qerret, Kavajë,** me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumi 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Ermira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është **2,520,000 Lekë**;

-"Truall", me sipërfaqe **2497 m2**, nga e cila **2497 m2** truall dhe **161 m2** ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumi 4, faqe 247, rregjistruar në pronësi të Armand Shuaipi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2173 Rep, Nr. 1409/2 Kol, datë 24.08.2010.Çmimi fillestar i ankandit është **3,133,065.6** Lekë;

- "Arë+Truall", me sipërfaqe **4,500 m2**, nga e cila **400 m2** truall dhe **176 m2** ndërtesë, ndodhur në Sallmone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumi 6, faqe 135, rregjistruar në pronësi të Bujar Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 657 Rep, Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipoteke Nr. 1512 Rep, Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010.Çmimi fillestar i ankandit është **9,534,672 Lekë**;

-"Dyqan", me sipërfaqe **60 m2** , ndodhur në **Rruga e Durrësit, Tiran**ë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 1201 Rep., Nr. 800/3 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është **53,424 Euro**.

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.04.2018.**

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora **16.00**, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore **"Strati Bailiff's Service"**, Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. **Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com**

Brenda 2017-ës, rreth 35 mijë pensione të reja pleqërie, invaliditeti e familjare

# Statistikat e ISSH-së, ja sa janë rritur pensionet brenda 7 vitesh

## Përllogaritja e masës mesatare mujore urbane dhe rurale

Voltiza Duro

Masa e pagesës që marrin pensionistët nga viti në vit ka pësuar pothuajse një rritje të pandjeshme. Sipas statistikave të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën janar-dhjetor 2017, pensioni mesatar mujor i një pensionisti në zonat urbane është në vlerën e 15.527 lekëve dhe të ardhurat mesatare mujore, ku përfshihen edhe kompensimet, arrijnë në 17.002 lekë. Respektivisht, për pensionet urbane, një pension mesatar mujor pleqërie shkon 15,527 lekë, ndërsa të ardhurat mesatare mujore arrijnë vlerën 17,002 lekë; ndërsa pensioni i invaliditetit mesatar mujor shkon 13,390 lekë e të ardhurat mesatare mujore për këtë lloj pensioni kapin shifrën 14,865 lekë. Ndërkohë, po për pensionet urbane, pensioni mesatar mujor familjar shkon deri në 6707 lekë, ndërsa të ardhurat mesatare mujore arrijnë vlerën 8181 lekë. Edhe pse ka ardhur në rritje, duke e parë për një periudhë të gjatë kohe, nga viti 2011 dhe deri më tani, rritja graduale e pensionit mesatar për këtë kategori ka qenë në masën rreth 2500 lekëve. E njëjta gjë ka ndodhur edhe për pensionet rurale. Aktualisht të ardhurat mujore mesatare për pensionistët në zonat rurale regjistrohen në vlerën e 8808 lekëve dhe të ardhurat mesatare mujore 9374 lekë. Kështu, rritja graduale regjistrohet në më pak se 2 mijë lekë brenda 7 vitesh.

**NUMRI I PENSIONISTËVE**

Brenda vitit 2017-të janë lidhur rreth 35 mijë pensione të reja, ndër të cilat mbi 28 mijë kanë qenë pensione pleqërie. Këto të dhëna vijnë nga analiza vjetore 2017 e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku është konstatuar se deri në fund të dhjetorit të 2017-ës numri total i personave që përfitojnë pension ka shkuar mbi 621 mijë. Vitin e kaluar janë lidhur rreth 35 mijë pensione të reja të të gjitha llojeve, ekzaktësisht 34.458 përfitues të rinj. Nga këto, janë rreth 28.200 pensione pleqërie të reja që janë lidhur, rreth 4 mijë pensione invaliditeti dhe 2200 pensione familjare. Në total numri i personave që përfitojnë pension ka shkuar në 621.184, e verifikuar kjo deri në fund të dhjetorit të vitit 2017-të nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku pjesën kryesore të saj e zënë pensionet e pleqërisë, pasuar nga 69.400 pensione invaliditeti si dhe rreth 51 mijë përfitues të pensioneve familjare. Përveç këtyre, ka edhe disa lloje trajtimesh të veçanta, pensione të parakohshme, apo pensionet suplementare.

**SKEMA**

Prej reformës së 2014-ës nuk ka pasur asnjë ndryshim ligjor në skemën e pensioneve. Masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të kenë aplikantët dhe sa më e lartë të jetë paga, aq më e lartë do të jetë edhe masa e përfitimit. Ndërkohë, pensionet e tjera kanë ngelur po njësoj e nuk kanë asnjë lloj ndryshimi që prej reformës së 2014-ës, që ka hyrë në fuqi në 1 janar, pra janë sërish po të njëjtat kritere që kanë qenë.

**LEHTËSIRAT**

Në kuadër të reformës që ka ndërmarrë qeveria, janë rreth 75 dokumente që nuk u kërkohen më qytetarëve, ku përfshihen certifikatat, dëshmitë e penalitetit, vërtetime të cilat i disponon vetë institucioni e nuk është e nevojshme t'i kërkohet individit.

**TË ARDHURAT**

Sipas statistikave të ISSH-së, nga analiza vjetore për 2017-ën, të ardhurat janë realizuar 102% në total, ose gati 1.7 miliardë lekë më shumë që janë mbledhur. Gjatë këtij viti është konstatuar edhe një rritje e numrit të kontribuuesve me 6.4%, ose e shprehur ndryshe rreth 45 mijë persona, pra nga 718 mijë kontribuues në 2016-ën, është arritur në 763 mijë në 2017-ën. Ndërsa, përsa u përket shpenzimeve, sipas të dhënave, janë harxhuar rreth 117 miliardë lekë të reja, ose 3% më shumë se një vit më parë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore me të gjitha agjencitë e veta që ka kontakton fizikisht në sportele me rreth 600-800 mijë veta në vit. Ndërkohë, nëse një individi i janë djegur vitet e punës në një ndërmarrje ku ka punuar, në këto raste ISSH nuk mund të lidhë pensione pa pasur dokumentet përkatëse.







Faksimile e statistikave të ISH-së mbi të ardhurat mujore të pensionistëve

**15.527**

**LEKË,** pensioni mesatar mujor

Sipas statistikave të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën janar-dhjetor 2017, pensioni mesatar mujor i një pensionisti në zonat urbane është në vlerën e 15.527 lekëve dhe të ardhurat mesatare mujore, ku përfshihen edhe kompensimet, arrijnë në 17.002 lekë.

**2500**

**LEKË, RRITJA PREJ 2011-ËS**

Edhe pse ka ardhur në rritje, duke e parë për një periudhë të gjatë kohe, nga viti 2011 dhe deri më tani, rritja graduale e pensionit mesatar për këtë kategori ka qenë në masën rreth 2500 lekëve. E njëjta gjë ka ndodhur edhe për pensionet rurale.

---

### Mamografi dhe papteste falas nga mjekë turq dhe shqiptarë

# Zv/ministri i Shëndetësisë së Turqisë: Do trajtojmë falas një pjesë të grave me tumor

Të gjitha gratë e interesuara, kanë mundësinë që të kryejnë mamografinë dhe paptestin falas në sheshin 'Skënderbej' në kryeqytet deri në 5 prill, nën kontrollin e mjekëve turq dhe shqiptarë. Në javën e shëndetit, "autoambulanca rozë" që ka rrugëtuar nga Turqia në Shqipëri, do të ofrojë për 3 ditë këtë shërbim. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu dhe zv/ministri i Shëndetësisë së Turqisë, Ahmet Baha Ogutken ishin të pranishëm në ceremoninë e çeljes së kësaj nisme. "Jemi në javën e shëndetit, e cila kulmon me 7 Prill, në ditën Ndërkombëtare të Shëndetit, ndaj dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për të rikthyer edhe një herë vëmendjen te rëndësia që ka parandalimi i hershëm i sëmundjeve, posaçërisht sëmundjeve tumorale, sepse shpëton jetë! Ndaj dua të bëj një ftesë për të gjitha gratë që të mos e neglizhojnë kontrollin për kancerin e gjirit dhe kancerin cervikal, që për fat të keq, janë shkaktarët kryesorë të vdekjeve nga kanceri te gratë në Shqipëri",-tha Manastirliu. Kjo e fundit, gjithashtu, u ndal edhe te zgjerimi i programeve parandaluese të ofrimit të shërbimit në komunitet, aty ku janë nevojat, përmes mamografëve të lëvizshëm në të gjithë vendin.

"Vetëm në muajt e parë të këtij viti u kryen rreth 900 mamografi, ndërsa në vit realizohen rreth 5 mijë mamografi falas përmes mamografëve të lëvizshëm në të gjithë Shqipërinë. Nga ana tjetër, ne po fuqizojmë spitalet rajonale me aparaturat e nevojshme për ofrimin e shërbimit aty ku janë nevojat. Pesë mamografi të reja do të instalohen këtë vit në spitalet rajonale Durrës, Kukës, Vlorë, Dibër dhe Gjirokastër", - theksoi ministrja. Gjatë kësaj jave, qeveria turke po mbështet Ministrinë e Shëndetësisë së Shqipërisë me dy nisma dhe programe të rëndësishme, siç është "autoambulanca rozë" dhe trajnimi i mjekëve dhe infermierëve për urgjencën mjekësore. Zv/ministri i Shëndetësisë së Turqisë, z. Ogukten deklaroi se shërbimi do të ofrohet falas për të ndihmuar gratë shqiptare për parandalimin e hershëm të sëmundjeve tumorale. "Në kuadër të luftës ndaj kancerit, kjo ambulancë shëtitëse ka bërë 1000 km, ka udhëtuar 15 orë, dhe ka ardhur nga Turqia në Shqipëri për të ndihmuar gratë shqiptare. Ne shpresojmë që të gjitha gratë të rezultojnë të shëndetshme nga këto ekzaminime, por nëse do të ketë gra që do të kenë probleme të lidhura me tumoret, ne do të garantojmë kurimin e një pjesë prej tyre në klinikat tona në Turqi",-u shpreh zv/ministri i Shëndetësisë së Turqisë, Ogukten. "Autoambulanca rozë" do të qëndrojë 3 ditë në sheshin 'Skendërbej' nga ora 09.00-18.00 për të ofruar shërbimin e mamografisë dhe paptestit falas për gratë.



Ministrja e Shëndetësisë Ogerta Manastirliu dhe zv/ministri i Shëndetësisë së Turqisë, Ahmet Baha Ogutken në ceremoninë e çeljes së nismës

**MINISTRI TURK AHMET OGUKTEN**

"Ne shpresojmë që të gjitha gratë të rezultojnë të shëndetshme nga këto ekzaminime, por nëse do të ketë gra që do të kenë probleme të lidhura me tumoret, ne do të garantojmë kurimin e një pjesë prej tyre në klinikat tona në Turqi",-u shpreh zv/ministri i Shëndetësisë së Turqisë, Ogukten.

### Ministri Gerd Muller: Programi synon të ndihmojë emigrantët

## Gjermania, 500 milionë euro për kthimin e emigrantëve, përfshihet edhe Shqipëria

Gjermania planifikon të shpenzojë plot 500 milionë euro brenda një viti për rikthimin e emigrantëve në vendet e tyre të origjinës, ku përfshihet edhe Shqipëria. Në një prononcim për mediat gjermane, ministri i Zhvillimit në këtë shtet, Gerd Muller ka bërë me dije se do të jepet mundësia për zgjerimin e programit vullnetar të emigrantëve, program në të cilin bën pjesë edhe Shqipëria, e është theksuar fakti se buxheti për të realizuar këtë duhet të trefishohet. E gjithë kjo sipas Muller do të realizohet pasi kushton më lirë sesa mbajtja e të huajve në shtetin gjerman. "Në programin e emigrantëve të kthyer në vendet e origjinës, do të vihen në dispozicion plot 500 milionë euro në vit. Kjo është shumë më lirë sesa furnizimi i njerëzve këtu në Gjermani", - tha ministri. Deri më tani, 150 milionë euro janë rezervuar për programin e Ministrisë Gjermane të Zhvillimit, që filloi në mars të vitit 2017. Ai ka për qëllim të ndihmojë azilkërkuesit që të fitojnë një terren me perspektivë për kthimin e tyre nga Gjermania në vendin e origjinës, duke ofruar këshilla për fillimin e biznesit ose programe të trajnimit profesional dhe punësimit. Vendet e synuara janë Shqipëria, Kosova, Serbia, Tunizia, Maroku, Gana, Senegali, Nigeria, Iraku, Afganistani dhe Egjipti. Më tej, Müller vlerësoi si një sukses programin "Cash for Work" të ministrisë së tij, i cili duhet të krijojë perspektiva për refugjatët sirianë në rajonin e tyre të origjinës. "Në dy vitet e fundit ne kemi qenë në gjendje të sjellim më shumë se 140,000 njerëz në punësim si mësuesit sirianë që mësojnë fëmijët refugjatë, ose njerëzit që ndihmojnë në rindërtimin e shtëpive, shkollave dhe lagjeve", - theksoi ministri.

**PROGRAMI**
"Në programin e emigrantëve të kthyer në vendet e origjinës do të vihen në dispozicion plot 500 milionë euro në vit. Kjo është shumë më lirë sesa furnizimi i njerëzve këtu në Gjermani", - tha ministri i Zhvillimit në këtë shtet, Gerd Muller.


Foto ilustruese

### Përgjegjësja e arsimit parashkollor, Rozalba Merdani: E vështirë të integrohen, sepse ata duan program individual

# Alarmi, 1 në 68 fëmijë i prekur nga autizmi

## *Çomo: Krizë në shëndetin publik, të ndërhyhet me terapi*

Voltiza Duro

Shifra alarmante para qiten nga viti në vit për sa i përket personave me çrregullime të spektrit autik në vendin tonë, ku regjistrohet një rritje prej 30-40%. Gjatë mbledhjes së Komisionit Parlamentar të Shëndetësisë ditën e djeshme u bë me dije se autizmi prek 1 në 68 fëmijë të lindur në Shqipëri dhe u theksua se shëndeti publik po hyn në krizë. "Ne jemi duke folur për rreth 300 raste në çdo brez fëmijësh, nëse jemi në 30 mijë lindje të reja. Kjo do të thotë se jemi në 3 mijë, nëse marrim nga mosha 2-11 vjeç e nëse shkojmë nga 2 deri në 22 do të thotë se do të duhet të jemi në numrin 6 mijë. Është një numër mjaft i madh krahasuar me atë që ndodh sot nëpër shërbimet tona, në pikëpamje të diagnostikimit. Edhe pse nga njëri 2 vjeçar në tjetrin prej 2010-ës dhe deri më sot, numri i rasteve të reja të diagnostikuara, shkon me 30-40% rritjeje çdo vit",- theksoi gjatë mbledhjes, shefi i Shërbimit të Psikiatrisë, prof. dr Ariel Çomo. Ky i fundit shtoi se është e domosdoshme që të zvogëlohet mosha e të prekurve dhe të ndërhyhet me terapi që në moshën 2 vjeçare. "Jemi sot në nivelin e gati 150% diagnostikim në secilin prej shërbimeve, krahasuar me pak vite më parë. Ajo çka është më e rëndësishme, është zvogëlimi i moshës të të prekurve, që Shqipëria është në gjendje sot të ndërhyjë. Krizë në shëndetin publik do të thotë që numri i rasteve të reja dhe ata që kanë nevojë është shumë më i madh sesa ç'është njerëzimi i përgatitur sot për sot",-shtoi Çomo. Edhe pse janë bërë përpjekje për frekuentimin e shkollës dhe integrimin e tyre me mësues mbështetës sërish arsimimi i fëmijëve me autizëm nuk realizohet siç duhet, pasi mësuesit mbështetës nuk janë të specializuar në trajtimin e çrregullimeve të spektrit autik. "Këta fëmijë përbëjnë rreth 26% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuar që ne kemi në sistem, pra çrregullimet e spektrit autik ndeshen shumë shpesh në arsim dhe përbëjnë edhe problem pasi është e vështirë të integrohen, sepse ata duan program individual", tha gjatë mbledhjes, Rozalba Merdani, përgjegjëse e arsimit parashkollor pranë MASR. Ndërkaq edhe shoqatat kanë ngritur si shqetësim mungesën e fondeve nga shteti për të ndihmuar të prekurit për marrjen e shërbimeve e më tej prindërit, të cilët kanë fëmijë me çrregullime të spektrit autik u bënë thirrje donatorëve për ndihme pasi privatisht nuk mund ta përballojnë trajtimin e tyre me gjithë shërbimet e nevojshme. Në mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Shëndetësisë, zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bardhylka Kospiri theksoi se është në fazë zbatimi ligji i ri i shërbimeve sociale, ku do të krijohet fondi social për mbështetjen e kësaj kategorie. "Edhe pse numri i fëmijëve të prekur ka ardhur duke u rritur në vendin tonë, shërbimin ata e kanë marrë të plotë. Megjithatë, ne po vazhdojmë të shohim më tej lidhur me hapa të tjerë në përmirësim të shërbimit për ta çuar edhe më pranë përfituesve dhe atyre që kanë nevojë të spektrit autik, duke punuar në zbatim të ligjit të shërbimeve sociale për të shkuar me shërbime në komunitet. Këto shërbime do të fillojnë të jenë të projektuara dhe të zbatuara edhe nga pushteti vendor, si rezultat i fillimit të zbatimit të fondit social",-u shpreh Kospiri.


Mbledhja e komisionit parlamentar të Shëndetësisë


Ariel Çomo

**TERAPI E HERSHME**
"Jemi sot në nivelin e gati 150% diagnostikim në secilin prej shërbimeve, krahasuar me pak vite më parë. Ajo çka është më e rëndësishme, është zvogëlimi i moshës të të prekurve, që Shqipëria është në gjendje sot të ndërhyjë. Krizë në shëndetin publik do të thotë që numri i rasteve të reja dhe ata që kanë nevojë është shumë më i madh sesa ç'është njerëzimi i përgatitur sot për sot",-shtoi Çomo.

**BARDHYLKA KOSPIRI**
**MË PRANË PËRFITUESVE**
"Ne po vazhdojmë të shohim më tej lidhur me hapa të tjerë në përmirësim të shërbimit për ta çuar edhe më pranë përfituesve dhe atyre që kanë nevojë të spektrit autik, duke punuar në zbatim të ligjit të shërbimeve sociale për të shkuar me shërbime në komunitet. Këto shërbime do të fillojnë të jenë të projektuara dhe të zbatuara edhe nga pushteti vendor, si rezultat i fillimit të zbatimit të fondit social",-u shpreh Kospiri.



**ROZALBA MERDANI**
**DUHET PROGRAM INDIVIDUAL**
"Këta fëmijë përbëjnë rreth 26% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuar që ne kemi në sistem, pra çrregullimet e spektrit autik ndeshen shumë shpesh në arsim dhe përbëjnë edhe problem pasi është e vështirë të integrohen, sepse ata duan program individual",-tha gjatë mbledhjes, Rozalba Merdani, përgjegjëse e arsimit parashkollor pranë MASR.



**300**
**RASTE**
"Ne jemi duke folur për rreth 300 raste në çdo brez fëmijësh, nëse jemi në 30 mijë lindje të reja. Kjo do të thotë se jemi në 3 mijë, nëse marrim nga mosha 2-11 vjeç e nëse shkojmë nga 2 deri në 22 do të thotë se do të duhet të jemi në numrin 6 mijë.

DEBATI

*Pas deklaratës së Pëllumb Xhufit 1 jave më parë për jetën në kampin e Tepelenës në komunizëm, kanë reaguar të mbijetuarit e kampit. "Kampi i Tepelenës ishte ndoshta kampi më i mirë. Ai i Maliqit ishte më i tmerrshëm. Askush nuk e thotë pse u ngrit ky kamp. Në këtë kamp u izoluan familjet kryesisht nga veriu", tha Xhufi. Ai shtoi se, "këta që e kanë promovuar çështjen e këtij kampi, ku është angazhuar edhe Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tepelenës, e kanë quajtur Aushvici shqiptar, kampi i shfarosjes në masë. Po ta dëgjojnë lobet çifute do të tmerrohen, sepse është një banalizim. Unë kam pasur rastin të shoh dokumentet e CIA-s për këtë kamp, që ishin informuar nga njerëz nga brenda. Ata thonë që këta janë familjet e njerëzve të arratisur të sponsorizuar nga Jugosllavia", - deklaroi Xhufi. Deklaratat e tij kanë shkaktuar lum kritikash.*

# I mbijetuari i kampit të Tepelenës: Xhufi mbron të vërtetën kriminale

## *Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991 sjell dëshminë e Shefqet Dobrës*



*Në foto:* Historiani Pëllumb Xhufi

Nga Shefqet Dobra

Unë kam qenë në atë kamp, nga fillimi, kur shkuam nga Berati deri në '54-ën. Kur u shkri ai kamp i mallkuar isha njëmbëdhjetë vjeç, gjë e ç'do pëllëmbë të atij vendi. Gjynah të qahemi, s'na paska munguar asgjë, më mirë e paskan ditur ata që nuk kanë qenë atje.

Njerëz të panjohur, që flitnin jo vetëm dialekte, por edhe gjuhë të ndryshme, burra, gra, fëmijë e të vjetër, madje edhe të sëmurë psikikë e sakatë, intelektualë e të pashkollë, i grumbulluan në këto kazerma të mëdha me katër radhe krevatesh, na vendosën partizançe, si lopët në stallat, flinin radhë familje pas familjeje, në ato krevate pa shkëputje. Ky ishte "kampi pushimit" të Tepelenës, ku këta njerëz duhet të mësoheshin të bashkëjetonin me njëri-tjetrin, në mungesë të lirisë dhe me rregullat e ashpra të burgut, por ky nuk ishte një burg sido kudo, jo, jo, ky ishte burg familjar, aty kishte njerëz nga një vjet deri në ndoshta nëntëdhjetë vjet. I rrethuar me tela me gjemba, ruheshin me roje të armatosur. Kjo do ishte jeta e këtyre njerëzve të quajtur fajtorë edhe se asgjë nuk kishin bërë, e të padënuar me ndonjë vendim gjyqësor.

Puna e parë që do bënin këta njerëz, ishte: të grumbullonin predhat që avionët e pushtuesve tanë - për të mos vrarë njerëz të pafajshëm, nuk i kishin hedhur predhat në qytet, por në pyllin e Bençës.

Ne, burra e gra, fëmijë e të vjetër, na vunë t'i grumbullojmë, u bënë aq stiva, sa ai vend dukej si fushë drush, shumë, sidomos fëmijë, u vranë nga ato të mallkuar. E ç'faj kishin pushtuesit se vriteshin ne, ai ruajti qytetarët e Tepelenës, ne na vunë që të vriteshim, nuk ka arsye tjetër; duheshin njerëz të specializuar për atë punë, jo ne. Edhe fusha brenda rrethimit ishte e minuar, shteti ynë nuk e kishin çminosur para se të na grumbullonin ne aty. Ato të mallkuara shpërthenin poshtë këmbëve tona, herë pas here, secila prej tyre merrte një ose më shumë jetë njerëzish, si të qëllonin, kjo ishte: njerëzit të vriten, e fajtor të mos kishte.

Eh, ç'janë kujtimet e vegjëlisë, ato nuk shlyhen kurrë nga kujtesa jonë, ato janë si themeli i shtëpisë që, edhe nëse shtëpia shembet, themelet janë të gatshëm të ngrihen mure tjera dhe vuajtjet e këtyre njerëzve, veçse përsëriteshin nga koha në kohë, gjithnjë më të vështira por, Tepelenën nuk mund ta harrojmë. Pasi mbaroi kjo punë e mallkuar, që u pagua me jetë njerëzish, nënat tona duhet të bënin dy rrugë të ngarkuara me dru, nga mali i Luzatit të furnizonin: mensat, furrat dhe zyrat e qytetit, edhe të kampit- këtu ne na kishin çuar për të bërë "qejf", për të ngrënë, na jepnin vetëm 400 gramë bukë misri thatë deri në pesëdhjetën.

Por, kishte edhe më keq; në 1950, një ditë, nuk i çuan në punë, na nxorën në fushë që në mëngjes, nuk dini çfarë prisnim, afër drekës, erdhën ca makina me të internuar tjerë nga Cërriku, ata i rreshtuan veç nesh. Pastaj, thirrën të gjithë të ata që ishin në moshë pune, nga kampi ynë, i hipën në makinat që prunë tjerët.

Dita e ndarjes ka qenë dita më e zezë; nënat qanin se, po linin fëmijët në mëshirë të fatit, fëmijët ulërinin, kur prindërit i hipnin në makinat, ishte tamam si kur ndanin shqerrat nga delet, por me një ndryshim, se për shqerrat kujdesej e i kulloste bariu, kurse për ne fëmijët, pleq e të sëmurët nuk kishte më kush të kujdesej.

Ne fëmijët e hanim atë pak bukë që në mbrëmje, pritnim kur të merrnin racionin mbrëmjen tjetër, të hanim, se nuk kishte prind të na e raciononte. Por, bujaria e shtetit nuk mbaronte, kishte punë edhe për ne të vegjlit. Kur vinim nga shkolla, na vinin të pastronim gurët, kur plugohej ekonomia ndihmëse e repartit. Ishte punë e rëndë për ne, t'i nxirrnim nga dheu dhe, t'i largonim me tezgë nga ara, ne ishim edhe të pangrënë, dhe nëse nuk kënaqej polici që na ruante, na dënonin: me birucë, ose na priste racionin e bukës.

Sot duket e pabesueshme, por jemi shumë që akoma jetojmë dhe i mbajmë mend këto mizori të atij kampi "dëfrimi" si thotë historiani i "nderuar" shoku Xhufi.

Kur ishim në Turan, ishin varret e italianëve shumë të rregullt, kurse në kampin e Beçës, ata që u vranë nga predhat ose nga minat, që ishin të mbuluar në fushën para kazermave, nga sëmundjet apo pleqëria, të cilët varroseshin, xhelati, mëkëmbësi i komandantit të madh: toger Hakiu, çdo pranverë, i plugonte. Pra, ne shqiptarët nuk duhet të kishim as varre. Ç'rëndësi kishte për ne, se ishin me tulla kazermat, ne ankoheshim për trajtimin, jo për muret. Në fund, të vdekurit, i varrosën te ura Bençës, atje i lamë, kur na larguan nga ky kampi i "qejfit" por, më vonë, edhe këta, i kishin prishur, dhe e dini pse? Siç më tregonte një plak vendali, në 2010-ën, kur kthehesha nga Greqia, shkova t'i shikoja varret e moshatarëve të mi - plaku kulloste delet aty - ai më pyeti ça po kërkoja; i thash se këtu ka pas ca varre - ai më tha:- Po si mund rrinin ato varre aty more djalë?



*Në foto:* Kampi i Tepelenës

- Pse? -i thash unë. Se ata varre ishin dëshmi për ekzistencën e atij burgu. Kur po shkonte Enveri ynë i "dashur" në Gjirokastër, kishte pyetur: - Ç'janë këto varre këtu mo? Janë të atyre të kampit - i kishin thënë.

-Bah!- kishte bërë. Po, përse nuk i kanë prishur akoma? Kur të kthenemi nga Gjirokastra, nuk dua t'i shëkonj më, më kupton apo jo? I plugoni, që mos u duket nam as nishan. Armiqtë tanë, edhe në varr o t'i ndjekë ndëshkimi ynë! - kishte thënë. Dhe brenda asaj dite, i pluguan - tha plaku.

Këta ishin sundimtarët e padinjitet, që hakmerreshin ndaj të pambrojturve, të pafajshmëve - me motivin se këta, ishin fajtorë vetëm se ishin fëmijë, nipa, stërnipa, apo kushërinj të "armiqve" dmth., këta ishin të dënuar bedela. Vetëm në Shqipërinë "demokratike" socialiste apo Shqipërinë lule, kishte tillë. Por ne nuk e paskemi ditur sa rehat paskemi qenë, paska tjerë, që nuk kanë qenë në atë kamp, që e ditkan më mirë nga ne.

Po, si intelektual Pëllumbi, të mbyllë sytë për disa minuta, ta imagjinoj veten të ishte moshën tonë, në atë në atë kamp "rehatllëku", me nënë, motër e tjerë, të vuante si ne, vetëm se është: djali, nipi, kushëriri apo dhëndër atje ku është dhe të jetonte në ato kushte që ishim ne, si do mund të fliste sot vallë?

Pëllumbi është një nga historianët më të mirë, në mbrojtje të së vërtetës kriminale të asaj kohe. Si historian, e ka për detyrë, në fund të fundit, të lehtësojë barrën e të parëve të tij.

## TEFTA RADI: FRANKO U DËNUA NGA DIKTATURA SE SOLLI RISI NË MUZIKË

Është vënë dje pranë kodrave të Liqenit Artificial një monument për kantautorin Françesk Radi. Në përurim morën pjesë miq e të afërm për ta përkujtuar. Shfaqet i ulur e me kitarë në dorë, siç mbahet mend prej të gjithëve, në vendin që ai deshi aq shumë në këtë qytet, ku me kitarën e pandashme krijoi meloditë e para.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, bashkëshortja e tij, Tefta Radi, u emocionua.

"Për mua, për familjen, për të gjithë adhuruesit e Frankos është një kënaqësi e madhe që e lëmë mes njerëzve. Ai do të mbahet mend si kantautori i parë shqiptar, si i riu që solli risinë në muzikën shqiptare, që futi modernen, për të cilën nga diktatura u dënua afro tri dekada, iu hoq e drejta e krijimtarisë në fushën e muzikës së lehtë, pa ia shuar kurrë pasionin për muzikën, sepse edhe në Pukë, edhe në Fushë-Arrëz, Frankoja punoi me të njëjtin pasion. Është një kujtim vërtet i bukur, faleminderit Bashkisë së Tiranës për gatishmërinë. Është një mrekulli", u shpreh mes emocionesh Tefta Radi, bashkëshortja e kantautorit.





Ndërsa kreu i bashkisë, Erion Veliaj tha se kantautori i njohur i muzikës shqiptare përmes tingujve dhe teksteve të tij ishte burim frymëzimi për shumë të rinj. "Franko ka ndryshuar shumë jetë njerëzish, ka prekur shumë individë e ka frymëzuar shumë të rinj. Për shumë njerëz ai ka qenë edhe arsye mbijetese në një situatë shumë të vështirë, ku fjala e lirë, muzika, opinioni, bindjet e lira kanë qenë sfidë për Shqipërinë. Vetëm ata që janë trima të vërtetë marrin guximin të sfidojnë në momentet më të vështira status-quon, realitetin, gjërat që ndodhin, të provokojnë një debat, atëherë kur të bëje një gjë të tillë, të kushtonte jetën. Ai i kushtoi vitet më të bukura të jetës, e megjithatë detyra e gjeneratës sonë, e një brezi të ri që merr stafetën nga një gjeneratë tjetër, është të mos harrojë dhe të kujtojë", tha Veliaj.

## NDRENIKA I KËRKOI TAKIM PËR TEATRIN, PRESIDENTI META PRET ARTISTËT

Presidenti i Republikës Ilir Meta do të presë sot në orën 11 një përfaqësi të aktorëve të Teatrit Kombëtar. Burime të GSh bëjnë me dije se takimi është thirrur nga Meta, pas kërkesës publike që i bëri të hënën Robert Ndrenika. Pas 2 muajsh protestë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar dhe kundër projektit të ri të prezantuar nga kryeministri Edi Rama, këtë të hënë Ndrenika u shpreh: "I bëj thirrje edhe Presidentit të Republikës, të prononcohet në këtë pikë: duhet ta bëjë shteti Teatrin Kombëtar apo jo? Në të njëjtin takim, aktori i njohur Nder i kombit i kërkoi Ramës t'i lërë të qetë artistët. Burimet shtuan për Gsh se do të jenë një përfaqësi aktorësh nga sindikatat e teatrit dhe artistëve, mes të cilëve besohet se është edhe vetë Ndrenika që bëri thirrje. Takimi do mbahet në presidencë.

# VIP Pages

Suplement

E mërkurë 4 Prill 2018 GAZETA SHQIPTARE


## "BULEVARDI POLITIK"

- Ministrja shqiptare fton qeverinë në dasmë, merr asistenten nuse për vëllain
- 47 vite më parë, 3 gratë më të fuqishme sot në botë
- "Byrek dhe dhallë", njihuni me deputetët e "varfër" të Kosovës
- Ngjela, Ramës: Birbo, pafille, ditëzi, injorant, derëzi...

## Moderatorja ndan momentet me të dashurin, ja si e imiton ai



## Rrëfehet Manjola Nallbani: Pse nuk publikoj shpesh foto me bashkëshortin



Flet juristja seksi: Si i evitoj ngacmimet në punë

# Redona Koçi:



## Ja për çfarë i kam refuzuar 10 mijë euro

*"Në jetën time është dikush jo xheloz, por që më inkurajon"*

Intervista

Flet juristja seksi: Si i evitoj ngacmimet në punë

# Redona Koçi: Ja për çfarë i kam refuzuar 10 mijë euro

*"Në jetën time është dikush jo xheloz, por që më inkurajon"*



Pamela Aliaj

*Shpeshherë në fokus të medias rozë janë bukuroshet e "Instagram"-it, modelet, të cilat jashtë kamerës së fotografit kanë edhe një profesion në jetë. Një ndër to është edhe ajo, që për një kohë të gjatë është quajtur në media "juristja seksi". Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Redona Koçi ka rrëfyer detaje nga jeta e saj si modele, faktin se e pse i dhanë këtë emër mediat si edhe pasionin e saj në jetë. Gjithashtu, e pyetur për jetën private si dhe ngacmimet në punën e saj, ajo na ka treguar disa të pathëna lidhur me to. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.*



**Jeni një nga juristet më tërheqëse të Shqipërisë. Pse zgjodhët pikërisht këtë fushë?**

Më kanë tërhequr gjithmonë studimet juridike dhe të pasurit një kulturë mbi to. Jam person që nuk i pranon padrejtësitë dhe studimet që kam kryer janë një mjet pikërisht për t'i luftuar këto.

**Ju pëlqen shpesh të provokoni me fotot në "Instagram". Si reagoni ndaj komenteve negative?**

Duke qenë personazh publik, jam e hapur dhe pranoj çdo lloj komenti, qofshin ato pozitive apo negative. Normalisht që pastaj janë komentet e njerëzve që më njohin në jetën reale që marrë për bazë.



**A keni pasur ngacmime në punën ku jeni, duke qenë se jeni tërheqëse?**

Të them të drejtën, profesionin e juristes nuk e ushtroj, kështu që s'ka ndodhur ndonjëherë.

**Para disa kohësh doli një bashkëbisedim i juaji me një person që ju kërkonte lekë për të pasur marrëdhënie intime me ju për një natë. A është e vërtetë? Çfarë komenti keni për këtë gjë?**

Këtë episod e kam sqaruar me një postim ku kam thënë se adresa nuk ka qenë e imja personale, ndaj sigurisht edhe bisedimi nuk ka qenë i vërtetë.

**A është dikush në jetën e Redonës? A është xheloz për fotot e postimet tuaja?**

Është dikush në jetën e Redonës dhe përveçse nuk është xheloz për postimet e mija, është inkurajuesi im i parë dhe më i madh në ndjekjen e pasionit tim.

**A keni pasur ngjarje ekstreme, ku dikush ju ka përndjekur në shtëpi apo kudo tjetër? Si keni reaguar?**

Jo shyqyr. Është diçka që nuk më ka ndodhur dhe uroj të mos më ndodhë as mua e as dikujt tjetër. Kurrë!

**Cili është mashkulli ideal për Redonën?**

Mashkulli ideal për mua është ai që arrin me personalitetin e tij, t'i bëjë ballë karakterit tim të fortë. Që më pranon, më kupton e më vlerëson për atë që jam. Dikush që nuk shtiret kurrë, siç nuk shtirem unë dhe që sidomos më mbështet në zgjedhjet e mija, duke mos u munduar kurrë të më ndryshojë apo të më ndrydhë personalitetin. Këto janë gjërat që më shumë më bëjnë të jem e qetë dhe e lumtur.




Ajo është një nga moderatoret simpatike të "Digitalb", e cila ka vendosur të jetë hermetike për jetën e saj private dhe të mos e ndajë atë në rrjetet sociale. Por kohët e fundit ajo ka nisur të postojë disa foto të tij në momente humori mes çiftit. I dashuri i Jona Spahiut, Frenkli, me dorën e ngritur afër kokës, kthyer në profil duket se e sheh kështu atë sa herë që pozon për aparatin fotografik. "Frenklo, si bën Jona kur del në foto?", ka shkruar moderatorja mbi foton, për të treguar se si Frenkli e imiton në momente si ky. Momente komike të çiftit e bëjnë akoma edhe më të shëndoshë lidhjen e tyre. Janë vërtet shumë simpatikë!

# Moderatorja ndan momentet me të dashurin, ja si e imiton ai

# Rrëfehet Manjola Nallbani: Pse nuk publikoj shpesh foto me bashkëshortin



Këngëtarja e njohur, Manjola Nallbani, kishte një nga personazhet e ftuar e "Në kurthin e Piter Pan". E ulur përballë fëmijëve, ajo ka zbuluar disa detaje nga jeta personale. Manjola është ndalur tek një detaj interesant nga jeta e saj private. Pse nuk e shohim këngëtaren në foto së bashku me bashkëshortin? Përballë një pyetje të tillë, Manjola ka thënë: "Njerëzit frymëzohen nga ne, nga muzika jonë. Ndërkohë që, bashkëshorti im, Sokoli, ka një profesion tjetër. Është gjykatës dhe nuk i pëlqen vëmendja e tillë e rrjeteve sociale". Pra, është një zgjedhje e partnerit të mos jetë në qendër të vëmendjes apo jo?






Pas një periudhe pauze, këngëtarja e njohur, Era Istrefi është duke sjellë projekte të reja në muzikë, që duken shumë mbresëlënëse. Vetëm para pak ditësh ajo publikoi këngën "Origami", në bashkëpunim me Maphorisa-n. Ndërkohë që është duke shijuar suksesin e këngës, ajo s'ka ndërmend të ndalet me kaq! Jo më larg se dje na ka treguar se është duke punuar për një tjetër bashkëpunim. Era ka postuar në "Instastory" një foto me këngëtarin e famshëm shqiptar, Claydee dhe ka shkruar se janë duke punuar së bashku. Këngëtari i hitit "Mamacita" ka bashkëpunuar më parë me Ermal Mamaqin, Faydee si dhe me këngëtarë të tjerë të njohur. Me siguri që edhe ky bashkëpunim do të ketë shumë sukses!

# Së shpejti një bashkëpunim i ri! Era Istrefi zbulon emrin e këngëtarit të famshëm











**Redona është juriste apo modele?**
Juriste në teori, modele në praktikë. Juriste në vizion, modele në pasion.

**Me fotot provokuese që keni në "Instagram", shumë njerëz mund t'ju ngacmojnë e me siguri edhe t'ju takojnë. Cili ka qenë propozimi më interesant?**
Fatmirësisht ose fatkeqësisht nuk kontrolloj ndonjëherë mesazhet që më vijnë me propozime apo të tjera biseda, sepse dita ime do duhet të ishte të paktën 48 orë dhe jo 24 orë. Për më tepër, nuk do mund të merresha me gjëra tjera, prandaj edhe nëse kam pasur ndonjë propozim interesant, thjesht nuk e kam lexuar.

**A ju kanë ofruar lekë? Cila ka qenë shifra me joshëse?**
Po, më kanë ofruar lekë në relacion me punën e modelingut që ushtroj. Shifra më interesante ka qenë për një reklamë për të cilën më ofruan 10.000 . Por, për arsye të tjera, ndryshe nga ato ekonomike, nuk pranova të isha pjesë e saj.

**Në ambientin e punës mundet t'ju ngacmojnë shpesh edhe për shkak të profilit që keni në "Instagram". Si reagoni?**
Kjo është diçka që ndodh kudo, jo vetëm në ambientin e punës, por është diçka me të cilën të duhet doemos të mësohesh, sepse jetojmë në një vend tej mase të vogël. Indiferenca dhe diplomacia janë kualitetet me të cilat arrin gjithmonë të ecësh përpara në rrugën tënde.

BULEVARDI POLITIK

Na merrni seriozisht!

# Ministrja shqiptare fton qeverinë në dasmë, merr asistenten nuse për vëllain

Pak ditë më parë, në familjen e ministres së Kosovës, Albena Reshitaj kishte festë të madhe, pasi martonte vëllain. Mes të ftuarve ishin edhe kryeministri Haradinaj, por edhe deputetët e qeverisë. Të ftuarit në dasmë kanë publikuar disa momente nga festa, ndërsa mediat kosovare zbulojnë edhe detaje të tjera. Sipas tyre, nusja e vëllait të ministres Rashitaj është Andrra Pllana, e cila mban pozitën e asistentes ekzekutive në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.



Nuk dihet nëse vëllai i ministres dhe asistentja e saj janë njohur para se Albena të bëhej ministre apo ka qenë ajo që i ka prezantuar.



# Ngjela, Ramës: Birbo, pafille, ditëzi, injorant, derëzi...

Shqipëria ende nuk ka një ligj për rrugët, prandaj për rrugët publike të ndërtuara nuk mund të bëhet asgjë koncesionare. Koncesioni i Ramës për Rrugën e Kombit është abuzim siu generis. Por gjithçka bëhet me qëllime destabilizimi dhe korrupsioni njëherësh". I këtij mendimi është avokati i njohur Spartak Ngjela, ish-mbështetës e aleat i Ramës, sot shndërruar në kritikun më të madh të tij. Ngjela e cilëson Ramën "birbo, pafille, mësues vizatimit, injorant" ndërsa thotë se ai po pret aktivizimin e masiv të protestave dhe kjo sipas tij, kuptohet nga fakti që kryeministri nuk heq dorë nga koncesioni i dhënë.

# 47 vite më parë, 3 gratë më të fuqishme sot në botë

Një fotografi e 47 viteve më parë. Të paktën kështu shkruan 'CNN'. Mund të dallohet qartë në të majtë ajo që prej 4 mandatesh radhazi ndodhet në krye të Gjermanisë, kancelarja Angela Merkel. Ishte revista "Time", që e publikoi foton pak vite më parë duke shkruar se Merkel kishte pozuar në krah të mikeve të saj në një festë të vitit të ri në Berlin në vitin 1971. Por cilat janë miket e saj. Media të ndryshme shkruajnë se në mes është kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May dhe në të djathtë, presidentja aktuale e CIA-s, Gina Haspel. Të tria janë moshatare me njëra-tjetrën, por ende nuk ka asnjë të dhënë që të tria vajzat të jenë ndodhur në të njëjtin vend në vitet '71-'72. Ka edhe nga ata që thonë se vajza në të djathtë nuk është Gina Haspel, por Dalia Grybauskait?, aktualisht presidente e Lituanisë. Derisa të ketë prova konkrete, teoritë e konspiracionit do të vazhdojnë.



# "Byrek dhe dhallë", njihuni me deputetët e "varfër" të Kosovës

Seanca parlamentare në Kuvendin e Kosovës ku u shqyrtua ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi është ndërprerë disa herë, pasi deputetët e VV-së kanë hedhur gaz lotsjellës, por orët e gjata të pritjes duket se i kanë lodhur disa prej deputetëve dhe kanë reflektuar lodhje tek ligjvënësit, të cilët janë detyruar të hanë bukë në tryezat e parlamentit. Dy deputetë kanë zgjedhur që të konsumojnë byrek dhe dhallë brenda sallës. Ky është një rast mjaft i rrallë për politikën shqiptare, të cilët jemi mësuar t'i shikojmë në lokale luksoze.



BULEVARDI POLITIK

Na merrni seriozisht!

INTERVISTA

# Ardian Ndreca:

## Rikthimi i inxhinier Gjadrit me "Letra grues seme të vdekur"

Elsa Doda

Letra grues seme të vdekur" është një nga botimet më interesante të kohëve të fundit. Libri ka si autor Gjovalin Gjadrin, inxhinierin e shquar sidomos për ndërtimin e Urës së Matit, i cili ishte shkruar në gjuhën gjermane dhe erdhi i përkthyer në shqip nga Ardian Ndreca. Prezantimi i këtij libri u zhvillua në ambientet e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, ku të afërm dhe miq u bënë pjesë e atij pështjellimi dashuror të rrallë. Inxhinier Gjadri humbi bashkëshorten e tij Zejnep në moshë fare të re nga së mundja e shekullit të shkuar, tuberkulozit dhe nis t'i shkruajë letra gruas së vdekur, në gjermanisht, me një stil unik dhe artistik. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" përkthyesi i veprës Ardian Ndreca, na tregon më tepër mbi historinë dhe personazhet duke dhënë dhe një mesazh: "Ura e vetme e përjetshme për të gjithë ata që besojnë jo vetëm tek jeta e përtejme, por tek dashuria është dashuria e vërtetë mes dy personave".

**Pse autori vendosi te shkruaj në gjermanisht?**

Autori i tronditur tej mase për vdekjen, humbjen e parakohshme vetëm pas pak vitesh martese, 7 vjet, mendon se thellësia e vuajtjes së tij dhe intimitetin e çasteve që kanë jetuar, të lumtura dhe të hidhura nuk mund t'i shkojë në dorë kujtdo prandaj e shkruan këtë libër në gjuhën gjermane dhe e boton në pak kopje, të cilat ia shpërndan pak miqve, ish-kolegeve të tij studentë dhe ish-kolegëve dhe miqve të shoqes së tij të jetës në Austri, Vjenë. Pra, ka një përzgjedhje që ka të bëjë me komunikimin indirekt që autori parapëlqen, e dyta ka të bëjë me vetë natyrën e tekstit. Është një tekst që ka një element autobiografik, shkon përtej biografisë ose kronologjisë së thjeshtë së një personi që vuan dhe humb personin e tij të dashur. Shumë njerëz në jetën e përditshme përballen me ngjarje tragjike, por këto ngjarje tragjike nuk prodhojnë vepra letrare. Kjo ngjarje është e tillë që çon autorin për të shkruar një vepër letrare. Autori është një inxhinier, jo se nuk ka inxhinierë që nuk kanë shkruar kurrë më parë letërsi, por për herë të parë ne jetën e tij Gjadri ka guximin që gjë në më të shtrenjtë përjetimet, përftimet e dhimbshme të jetës së tij t'ia besojë shkrimit. Me këtë vrull që është i diktuar prej dhimbjes ulet e shkruan një libër që e kryen në pak kohë.

**Çfarë e ndjek gjatë të gjithë shkrimit të veprës deri te dorëzimi i veprës tek lexuesi?**

E ndjek kujtimi i dashurisë për të shoqen, dhe nga ana tjetër, ndjenja se i është bërë një padrejtësi e madhe, autorin e të cilës është vështirë për ta gjetur. Duke qenë një person që është rritur me besimin në Zot e bën zotin fajtor për këtë që i ka ndodhur, dhe një pjesë e librit është një dialog, kërkesë për justifikim që i kërkon Zotit, pse e ke bërë këtë gjë? Është një temë antike të cilën e ndeshim te Seneka, Ciceroni në filozofi Kant, Lagnic në letërsi bashkëkohorë, eseistik. Ai kërkon ribashkimin me të dashurën e tij në një dimension tjetër përtej atij fizik duke i kërkuar Zotit të paktën tani që më ka ndodhur kjo padrejtësi unë dua prej teje të bashkohem me gruan të cilën dua që të ribashkohem me të sapo të mbaroj ky segment i jetës taksore. E pranon vuajtjen e tij, pasi gjëja e mirë vuajtjes është se ajo mbaron, bashkë me jetën për t'u ritakuar me gruan. Në kopertinë të librit shihet dhe një pikture origjinale që një kolege shoqe e Zejnepit ia kishte bërë në Vjenë në 1927. I gjithë ky diskurs artikulohet në mënyrë letrare filozofike dhe nëpërmjet formulimeve që janë të rralla. Ai thotë : "Unë nuk jam në gjendje të rris djalin tim pasi kam humbur të gjithë habituset, aftësitë për të dhënë diçka të mirë, pasi nuk kam më diçka të mirë për të dhënë". Fatmirësisht brenda tij kishte mbetur diçka shumë e mirë vetë fakti që ndjen prezencën e dashurisë kaq të thellë për gruan e tij. Nuk është një njeri i mbaruar prej vuajtjes, por njeri që purifikohet, ku nëpërmjet vuajtjes e vazhdon ta kujtojë gruan e tij, por jo tek kujtimi, figura memoria, por brenda vetes. Gjëja më reale e jona është uni jonë thotë Dekarti pastaj vjen trupi. Kjo është pak a shumë rrugëtimi filozofik dhe letrar i letrës.

**Cila është ura e vetme e qëndrueshme e Gjadrit?**

Fatkeqësisht një prej urave të tij më të famshme e hodhën gjermanet në erë gjatë Luftës së Dytë Botërore, urën e Gomsiqes e ndërtuar me një teknologji më pararojë për epokën. Urat materiale që bashkojnë dy brigje fatkeqësisht vjen një moment dhe prishen, por ura e vetme e përjetshme për të gjithë ata që besojnë jo vetëm tek jeta e përtejme, por tek dashuria është dashuria e vërtetë mes dy personave dhe më tej respekti, miqësia.

**Çfarë mesazhi përcjell ky libër?**

Sot flitet për dhunën në familje, e cila zakonisht është e mashkullit ndaj femrave ku shoqëria reagon shumë ngadalë. Leximi i këtij libri bë n të kuptosh që dhuna është diçka shumë primitive dhe dashuria shkon përtej konflikteve. Ato konflikte që mendojnë se zgjidhen nëpërmjet dhunës janë vetëm nga një mendje barbare. Ndaj femrës, bashkëshortes duke qenë dhe nënë duhet një respekt i dyfishte për rolin krijues qe ka, nga ana tjetër është çështja e dashurisë. Mendoj që çdo femër do të kishte ëndërruar po të kishte fatin e keq për të vdekur para bashkëshortit të saj, që t'i shkruhej një libër i tillë ose edhe dy rreshta të tillë , një letër e vetme që dashurie jo një vepër, e cila tregon se atë e ka dashur një person me gjithë qenien.

**Pse autori vendos ta botojë me pseudonim?**

Kjo arsye është e lidhur gjithnjë me komunikimin indirekt, i cili është i lidhur me pseudonimin. Shkrimtari komunikon me lexuesin jo drejtpërdrejt, kjo mënyrë realizohet nëpërmjet pseudonimit, pra nuk jam unë, por është Gmaraj dhe nuk është gjuha shqipe, por një gjuhë e huaj për të ruajtur dhe transferuar autoritetin e fjalës sime nëpërmjet një filtri. Shumë herë ne e përdorim këtë mënyrë në jetën e përditshme, p.sh. parlamenti përdor zëdhënësen, ministri zyrën e shtypit etj., këtu kemi të bëjmë me letërsi dhe ky komunikim nuk i heq vlerat letërsisë, por në atë moment është një rrugëtim që mundohet të ruajë të pacenuar anën shpirtërore dhe intimitetin e ndjenjës.

**Pse ju vendosët ta përkthenit në gegërisht?**

E kam përkthyer se përkthimi i pari është i paplotë, dhe ne gegërisht, sepse, nëse autori vetë do ringjallej dhe do ta kishte shkruar në gjuhën shqipe padyshim qe do ta kishte shkruar në gegërisht. Gegërishtja ka aftësi stilistike, thellësi në fjalor dhe thellësi mendimi. I ka te gjitha këto instrumenti. Më ka lodhur, por e kam bërë me pasion.

*Ura e vetme e përjetshme është dashuria e vërtetë mes dy personave*


*Në foto:* Gjovalin Gjadri dhe gruaja e tij, Zejnep


*Në foto:* Zejnepi, dalë në Vjenë *(fillimi i viteve '30)*

### "LETRAT" E GJADRIT I SILLNIN BOTËS SONË KULTURORE DUKURINË E SHKRIMIT INTIM

PERSIDA ASLLANI

Letra gruas sime të vdekur" është një dukuri specifike në kulturën shqiptare të librit. Ai është shkruar e botuar gjermanisht nga një zemër burrërore shqiptare që frymonte kulturalisht në botën mendore e letrare të ish-perandorisë austro-hungareze, një hapësire sa etatike aq edhe botëkuptimore që i mbijetoi shpërbërjes së vet gjeopolitike si një kujtim e entitet i fortë kulturor e shpirtëror. Prandaj dhe prezantimin e përkthimit të ri e të plotë të tij në shqip parapëlqyem ta zhvillonim pikërisht në mjedisin e Sallës gjermanofone të leximit në Bibliotekën Kombëtare si për ta shenjuar me një metaforë hapësinore natyrën duale të këtij teksti emblematik po aq sa ç'ishte emblematik për breza të tërë vetë autori i tij, inxhinieri.

**GJOVALIN GJADRI**

Teksa e botonte këtë epistolar intim nën drojën e pseudonimit G.Maranaj gjatë vitit 1943, ai ndërtonte teatrin e jetës e të vdekjes nën dritën e errët të dashurisë së humbur dhe i mbyllte letrat e tij me përulësinë e madhështinë e dhimbjes së thellë duke i pohuar kujtimit të gruas së vdekur se "due me të nderue tue mbajt zi". Të shkruara në gjuhën gjermane dhe të lidhura qindra fijesh me regëtimet e letërsisë së thellësive të shpirtit, tipar përkufizues i letërsisë austriake, po qa sa me përsiatjen filozofike mbi jetën e vdekjen, e sidomos mbi dashurinë e patjetërsueshme, "Letrat" e Gjadrit i sillnin botës sonë kulturore dukurinë e shkrimit intim e të kërkimit refleksiv të vetvetes e të qenies se dashur (e të dashuruesheme). A do të kish mundur t'i sillte ato në shqip? E vështirë, por jo e pamundur! E vështirë për aq sa mjedisi kulturor e ligjërimor i viteve '40 nuk e kish fituar ende zhdërvjelltësinë e pohimit të intimes vetjake. E vështirë për aq sa "vaji i burrit" ishte "gjâma" dhe heshtja. E vështirë për aq sa nevoja e autorit të tyre të qe pohimi i ndjesive më të thella të dëshpërimit në një gjuhë ku nuk themelohej, por vijonte tradita e këtij lloji të shkrimit e shprehjes. Por jo e pamundur! Përkthimi gegnisht nga filozofi Ardian Ndreca përbën për mua provën më të mirë: elegancë, thellësi mendimi e shprehjeje, ritëm e muzikalitet mbresëlënës. Ky përkthim ia kthen Gjadrin lexuesit shqiptar e kulturës shqiptare. I kthen hijeshinë e gjuhës dhe tonet e forta të mendimit, ndonëse përmes dëshpërimit e vajit, për ta shpënë, siç dhe autori i tij ka shpresuar, në pohimin burrëror shqip të një "dashurie të përjetshme e në zi".

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, vendimet nga vitit 2008 deri në vitin 2017

Ornela Manjani

# Pronat që nuk kanë marrë kompensimin, aplikimi për 3500 dosje

## *Lista me përfituesit, 6 dokumentet që duhet të dorëzohen në Agjenci*

Pronarëve që u është zënë tona nga ndërtimet pa leje, dhe nuk kanë marrë ende kompensimin duhet të paraqiten në Agjencinë e Trajtimit të Pronave për të përfituar prej fondit prej 18.9 miliardë lekësh. Këto para do t'i përfitojnë rreth 3500 pronarë në të gjithë vendin. "Bazuar në aplikimet e kryera në ATP deri më tani për këtë proces, rezulton se rreth 3'500 subjekte përfitues nuk janë paraqitur fare në ATP për të aplikuar me qëllim përfitimin e shpërblimit të miratuar për ta në VKM-të përkatëse. Duke qenë se ky proces nuk është i kushtëzuar dhe i limituar në kohë, ATP fton të gjithë këta subjekte përfitues që të paraqiten pranë sporteleve të saj për të aplikuar me qëllim përfitimin e kompensimit të miratuar. APT, në varësi të të ardhurave të arkëtuara deri më sot për këtë proces nga ALUIZNI dhe fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, sipas përllogaritjeve përkatëse shpërndan aktualisht 70% të vlerës së miratuar në VKM për subjektet përfituese"-thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave, të cilit i bashkëlidhet edhe lista me 3500 pronarët. Pronarëve, toka e të cilëve është zënë nga ndërtimet informale, u është njohur e drejta e kompensimit me vendim të Këshillit të Ministrave ku është përcaktuar edhe shuma për secilin, por për të marrë paratë duhet të dorëzojnë në ATP 6 dokumente.

**PROCEDURAT**

Procedura e aplikimit nga subjektet përfitues është e thjeshtë. Bazuar në VKM nr.383 datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar, subjektet përfitues mund të paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Nëse kërkesa paraqitet nga një pjesë e bashkëpronarëve, ajo shoqërohet nga prokura e posaçme e nënshkruar prej tyre, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

**DOKUMENTET**

1. Kërkesën për kompensim sipas formatit tip, e cila plotësohet në ATP;
2. Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.
3. Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre;
4. Vërtetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;
5. Mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit;
6. Dokument identifikimi.

| Emri Atësia Mbiemri | | | Numri i zonës kadastrale | Numri i pasurisë | Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m²) | Vlera truallit | Vlera e shpërblimit (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **AZEM ABDULLAH TOKA** | | | **8591** | **17/626** | **300.00** | | **6,469,200.00** |
| **AGIME SHABANI** | | | **8591** | **17/615** | **168.00** | | **3,622,752.00** |
| **LUMNIJE SHABANI** | | | | | | | |
| **AGIME SHABANI** | | | **8591** | **17/616** | **300.00** | | **6,469,200.00** |
| **LUMNIJE SHABANI** | | | | | | | |
| **BEHRAN ISUFI** | | | **8591** | **17/416** | **316.2** | | **6,818,537.00** |
| ALTIN | ZEQIR | BENGA | 2884 | 565/1/2 | 680.50 | 3750.00 | 2,551,875.00 |
| FATIME | | BUJA | 8340 | 9/227 | 486.20 | 26094.00 | 12,686,902.80 |
| BEDRIJE | | SULA | | | | | |
| LUMNIJE | | SULA | | | | | |
| RUKIJE | | SULA | | | | | |
| REXHEP | | SULA | | | | | |
| QEMAL | | SULA | | | | | |
| SHKENDIJE | | SULA | | | | | |
| FATBARDH | | SULA | | | | | |
| KASEM | | SULA | | | | | |
| BEHANE | | SULA | | | | | |
| LILJANA | | SULA | | | | | |
| IBRAHIM | | SULA | | | | | |
| SIMIR | | SULA | | | | | |
| KADRI | | ALUSHI | 8340 | 9/222 | 514.50 | 26094.00 | 13,425,363.00 |
| SALI | | ALUSHI | | | | | |
| AGIM | | ALUSHI | | | | | |
| MYRTEZA | | FYSHEKATA | | | | | |
| SHPRESA | | KOLLOBANI | | | | | |
| LUMTURIE | | KOKOBOBO | | | | | |
| IKE | | DODA | 8340 | 9/286 | 102.70 | 26094.00 | 2,679,853.80 |
| MUSTAFA | | SULA | 8340 | 9/288 | 633.30 | 26094.00 | 16,525,330.20 |
| FATIME | | SULA | | | | | |
| FIQIRETE | | SULA | | | | | |
| BESNIK | | SULA | | | | | |
| FLUTURA | | SULA | | | | | |
| PETRIT | | SULA | | | | | |
| HAMDI | | RECA | | | | | |
| VJOLLCA | | RECA | | | | | |
| HAJRIE | | RECA | | | | | |
| AIDA | | RECA | | | | | |
| BASHKEPRONARET BRARI | | | 8170 | 1/257 | 168.00 | 21593.00 | 3,627,624.00 |
| MYZAFER FEHIM BRAHO | | | 8170 | 1/264 | 16.20 | 21593.00 | 349,806.60 |
| DRANDE | MARK | SADIKU | 8110 | 4/61 | 71.80 | 24360.00 | 1,749,048.00 |
| SEFER | | MARKAJ | 8110 | 4/62 | 116.60 | 24360.00 | 2,840,376.00 |
| **FABRIJE** | | **LIKA(ISUFI)** | **8110** | **5/180** | **1,403.9** | **24,754** | **34,752,140.60** |
| **HAMZA** | | **ISUFI** | | | | | |
| **MAHMUT** | | **LIKA** | | | | | |
| **KADIRE** | | **LALA** | **8340** | **1/119** | **10.3** | **26,094** | **268,768.20** |
| **INDRIT** | | **LALA** | | | | | |
| **ENGJELL** | | **CORLAZE** | **8340** | **3/134** | **22.1** | **26,094** | **576,677.40** |

| Emri Atësia Mbiemri | | | Numri i zonës kadastrale | Numri i pasurisë | Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m²) | Vlera truallit | Vlera e shpërblimit (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **AHMET** | | **KRUJA** | **8220** | **2/314** | **497.2** | **28,659** | **14,249,254.80** |
| **XHEMAL** | | **KRUJA** | | | | | |
| **BASHKIM** | | **KRUJA** | | | | | |
| **RIGELS** | | **KRUJA** | | | | | |
| **NJAZI** | | **AGA** | **8220** | **2/312** | **169.1** | **28,659** | **4,846,236.90** |
| **RAMAZAN** | | **AGA** | | | | | |
| **SH.A "MEKANIKA"** | | | **8310** | **5/136** | **56.0** | **20,473** | **1,146,488.00** |
| **AHMET** | | **HOXHA** | **8230** | **2/435** | **246.0** | **20,473** | **5,036,358.00** |
| **MINIRE** | | **VRAPI** | | | | | |
| **GANIMETE** | | **HOXHA** | | | | | |
| **AISHE** | | **HOXHA** | | | | | |
| **MIT'HAT** | | **FRASHOLLI** | **8130** | **3/336** | **508.3** | **24,754** | **12,582,458.20** |
| **SEMIHA** | | **FRASHOLLI** | | | | | |
| **FATMIR** | | **FRASHOLLI** | | | | | |
| **SELMAN** | | **FRASHOLLI** | | | | | |
| **MURAT** | | **GJOKA** | **8330** | **9/405** | **467.0** | **26,137** | **12,205,979.00** |
| **DURIM** | | **KULLA** | **8521** | **8/454** | **9.3** | **18,000** | **167,400.00** |
| **ZEJNEP** | | **KULLA** | | | | | |
| **BESNIK** | | **KULLA** | | | | | |
| **HASIBE** | | **KULLA** | | | | | |
| **DHURATA** | | **SULSTAROVA** | | | | | |
| **ENGJELLUSHE** | | **MILO** | | | | | |
| **ZANA** | | **KALTANI** | | | | | |
| **FATMIR** | | **KULLA** | | | | | |
| **SHYQYRI** | | **KULLA** | | | | | |
| **QEMAL** | | **KULLA** | | | | | |
| **MYZEJEN** | | **KULLA** | | | | | |
| **PETRIT** | | **SHTALBI** | | | | | |
| **SADET** | | **SHTALBI** | | | | | |
| **MUSTAFA** | | **CAUSHI** | | | | | |
| **MUHARREM** | | **CAUSHI** | | | | | |
| **MERJEME** | | **KARALLIU** | **8541** | **26/165** | **10.9** | **6,000** | **65,400.00** |
| **DILAVER** | | **KARALLIU** | | | | | |
| **VILHELM** | | **KARALLIU** | | | | | |
| **AGRON** | | **KARALLIU** | | | | | |
| **SAFET** | | **KARALLIU** | | | | | |
| **SUZANA** | | **KARALLIU** | | | | | |
| **HEDIJE** | | **KARALLIU** | | | | | |
| **MANUSHAQE** | **SULEJMAN** | **MIKO** | **8543** | **5/60** | **250.0** | **7,000** | **1,750,000.00** |
| **NURFO** | | **MIKO** | | | | | |
| **MIMOZA** | **MUHAREM** | **MIKO** | | | | | |
| **MERITA** | **MUHAREM** | **HASANTARI (MIKO** | | | | | |
| **HASBIE** | **QANI** | **HOXHA** | | | | | |
| **LILJANA** | **QANI** | **KOSOVA** | | | | | |
| **VALENTINA** | **QANI** | **KALEMAJ** | | | | | |
| **SHPRESA** | **DERVISH** | **HASHO** | | | | | |
| **BUJAR** | **DERVISH** | **ZAZO** | | | | | |
| **SERVET** | **DERVISH** | **ZAZO** | | | | | |
| **TEFTA** | **DERVISH** | **SHEHI (ZAZO)** | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HATIXHE | | KOSTA (KUKA) | | | | | |
| VIOLETA | | KUKA | | | | | |
| ILIR | | KUKA | | | | | |
| FATO | | KOKALARI | | | | | |
| SELFO | | KUKA | | | | | |
| AHMET | | KUKA | 8543 | 6/30 | 200.0 | 7,000 | 1,400,000.00 |
| FATBARDHA | | PUMO (KUKA0 | | | | | |
| BUJAR | | KARAGJOZI | | | | | |
| ARJAN | | KARAGJOZI | | | | | |
| FATOS | | KARAGJOZI | | | | | |
| MIRELA | | TUSHE (KARAGJO | | | | | |
| BUKURI | XHELO | BIXHAKU | | | | | |
| JONUZ | RESHAT | BIXHAKU | | | | | |
| RAHIME | RESHAT | BIXHAKU | | | | | |
| XHENO | RESHAT | BIXHAKU | 8543 | 3/83 | 60.9 | 7,000 | 426,300.00 |
| GEZIM | RESHAT | BIXHAKU | | | | | |
| KUJTIM | RESHAT | BIXHAKU | | | | | |
| REIZ | RESHAT | BIXHAKU | | | | | |
| MIFTAR | ASLLAN | CENA | 2315 | 51/23 | 35.8 | 2,000 | 71,640.00 |
| XHIXHE MUCA(BP) | | | 2380 | 80/68 | 1,999.46 | 1,865.0 | 3,728,992.90 |
| GENC DUKA(BP) | | | 2380 | 80/11 | 79.96 | 1,865.0 | 149,125.40 |
| GANI | | MEMA | | | | | |
| MUHAMET | | MEMA | | | | | |
| SHABAN | | MEMA | 8350 | 1/33 | 159.90 | 39,533.0 | 6,321,326.70 |
| RESHAT | | MEMA | | | | | |
| METIJE | | BEJLERI | | | | | |
| SULO | | SULAJ | 3866 | 315/102 | 339.20 | 2,578.0 | 874,457.60 |
| SOKOL | | XHIXHABESI | 3866 | 315/200 | 310.40 | 2,578.0 | 800,211.20 |
| BUJAR | M | EGRA | 3866 | 306/67 | 394.80 | 2,578.0 | 1,017,794.40 |
| PELLUMB | | AVDILLARI | 3866 | 315/189 | 86.00 | 2,578.0 | 221,708.00 |
| SHYQYRI | | SULAJ | 3866 | 305/68 | 418.20 | 2,578.0 | 1,078,119.60 |
| LUAN | | SULAJ | 3866 | 305/71 | 419.90 | 2,578.0 | 1,082,502.20 |
| FLAMUR | | SAKOLLARI | 3866 | 306/39 | 322.20 | 2,578.0 | 830,631.60 |
| LUMTURI | | PUPE | 3866 | 306/40 | 379.20 | 2,578.0 | 977,577.60 |
| EDUART | | GRONO | 3866 | 306/42 | 266.30 | 2,578.0 | 686,521.40 |
| PETRO | | POTKA | 3866 | 306/261 | 271.30 | 2,578.0 | 699,411.40 |
| TRASH. BRARI | | | 8170 | 3/20 | 1,389.90 | 21,593.0 | 30,012,110.70 |
| MENTOR | | SKENDERI | 8330 | 1/361 | 46.00 | 26,137.0 | 1,202,302.00 |
| MENTOR | | SKENDERI | 8330 | 1/359 | 16.00 | 26,137.0 | 418,192.00 |
| Sadik | Beshir | Vrioni | 8522 | 7/230 | 75.40 | 7000.00 | 527,800.00 |
| Suzana Xhavit Maliqi | | | 1919 | 25/59 | 12531.60 | 1028.00 | 12,882,484.80 |
| Nevrez Xhavit Gjylbegu | | | | | | | |
| Myrvete | Bunga | (Trash-9) | 8523 | 28/40 | 1.80 | 9000.00 | 16,200.00 |
| Mahmut | Shengjergji | (Trashegi-30) | 8523 | 28/41 | 785.90 | 9000.00 | 7,073,100.00 |
| Leme | Shengjergji | (Trashegi-30) | | | | | |
| Qazim Mehmet Filja | | | 8524 | 1/281 | 1234.60 | 17500.00 | 21,605,500.00 |
| Qazim Mehmet Filja | | | 8524 | 1/282 | 789.10 | 17500.00 | 13,809,250.00 |
| VASIL | TUSHI | LLAKMANI | | | | | |
| SOFIJE | TUSHI | LLAKMANI | | | | | |
| VANGJELI | TUSHI | LLAKMANI | 3664 | 17/4 | 286.60 | 1490.00 | 427,034.00 |
| PANDELI | JOVAN | LLAKMANI | | | | | |
| ELIVERTA | JOVAN | LLAKMANI | | | | | |
| ROZA | JOVAN | LLAKMANI | | | | | |
| NEVRUZ | | GUXHOLLI | 8581 | 4/354 | 20.24 | 16500.00 | 333,960.00 |
| BEKTASH | | GUXHOLLI | | | | | |
| Atalanta PEKEMEZI dhe B. P. PASKO | | | 8581 | 1/361 | 134.00 | 16500.00 | 2,211,000.00 |
| TAHIR | | | | | | | |
| PAVLLO | | | | | | | |
| ZHANETA | SEJFI | AGOLLI | 2573 | 3/498 | 43.15 | 1900.00 | 81,985.00 |
| SHQIPERIE | | | | | | | |
| VERGJINUSH | | | | | | | |
| RAZIE | | | | | | | |
| Bace | | KOLANAECI | | | | | |
| Marjela | | KOLANAECI | 2573 | 1/214 | 779.30 | 1900.00 | 1,480,670.00 |
| Fredi | | KOLANAECI | | | | | |
| Eriketa | | KOLANAECI | | | | | |
| ALEKSANDER | | GAVOCI | 8270 | 7/197 | 65.00 | 120,000.0 | 7,800,000.00 |
| LUMNIE | | VOKOPOLA | | | | | |
| ENEIDA | | VOKOPOLA | 8380 | 7/121 | 274.80 | 120,000.0 | 32,976,000.00 |
| ALBENS | | VOKOPOLA | | | | | |
| Emin Haxhiademi (Trashegimtaret ) | | | 8522 | 12/186 | 159.60 | 18,500.0 | 2,952,600.00 |
| Shoqeria "Elsa" | | | 8521 | 12/140 | 39.10 | 10,000.0 | 391,000.00 |
| DURIM | | KULLA | | | | | |
| ZEJNEP | | KULLA | | | | | |
| BESNIK | | KULLA | | | | | |
| HASIBE | | KULLA | | | | | |
| DHURATA | | SULSAROVA | | | | | |
| ENGJELLUSHE | | MILO | | | | | |
| ZANA | | KALTANI | | | | | |
| FATMIR | | KULLA | 8521 | 8/454 | 3.60 | 18,000.0 | 64,800.00 |
| SHYQYRI | | KULLA | | | | | |
| QEMAL | | KULLA | | | | | |
| MYZEJEN | | KULLA | | | | | |
| PETRIT | | SHTALBI | | | | | |
| SADET | | SHTALBI | | | | | |
| MUSTAFA | | ÇAUSHI | | | | | |
| MUHARREM | | ÇAUSHI | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HANCE | SADRI | LLAPUSHI | 1842 | 9/195 | 28.00 | 2,000.0 | 56,000.00 |
| & (BASHKEPRONARE-13) | | | | | | | |
| ARIF | HAXHIYMER | KOÇANI | 8521 | 13/14 | 283.20 | 10,000.0 | 2,832,000.00 |
| & (TRASHEGIMTARET) | | | | | | | |
| ERIMRA | QEMAL | PERIHANA | | | | | |
| ISMAIL | QEMAL | PERIHANA | 8527 | 174/8 | 1,001.90 | 1,028.0 | 1,029,953.20 |
| ARTA | QEMAL | ZEKO | | | | | |
| Bashkesia Kishes (Gjermane) Opertzon Mobiliztion Krugen Sacks Dane Hansen Friedemanin Becks | | | 8571 | 4/75 | 13.70 | 8,000.0 | 109,600.00 |
| | SHOQERIA ARMO SH.A | | 3682 | 3/1 | 300.00 | 2,100.0 | 630,000.00 |
| Raimondo | Vincenzo | Forcina | 8591 | 1/116 | 28.00 | 15,000.0 | 420,000.00 |
| Ferid | Qamil | Bushati | 8591 | 6/422 | 5.38 | 15,000.0 | 80,700.00 |
| Myrvete | | (Mani) Elezi | 8591 | 6/516 | 4.65 | 15,000.0 | 69,750.00 |
| Muhamet | | Kraja | | | | | |
| Sebije | | Kraja | 8591 | 8/468 | 17.20 | 8,500.0 | 146,200.00 |
| Isuf | | Kraja | | | | | |
| Hamza | | Meti | 8591 | 8/487 | 10.00 | 8,500.0 | 85,000.00 |
| Eduard | | Bilali | 8591 | 8/360 | 13.80 | 8,500.0 | 117,300.00 |
| Sabah | | Domnori | | | | | |
| Gezim | | Domnori | 8591 | 5/282 | 51.50 | 8,500.0 | 437,750.00 |
| Saniqe | | Domnori | | | | | |
| Zija | | Kraja | | | | | |
| Sabri | | Kraja | | | | | |
| Ylfete | | Kraja | | | | | |
| Naxhije | | Kraja | 8591 | 8/1030 | 183.00 | 8500 | 1,555,500.00 |
| Fatbardha | | Kraja | | | | | |
| Shyqyri | | Kraja | | | | | |
| Suzana | | Kraja | | | | | |
| VIRON | KRISTOFOR | GOXHABASHI | | | | | |
| ZHANETA | GORI | GOXHABASHI | | | | | |
| ALKET | NIKO | GOXHABASHI | | | | | |
| LEDIA | NIKO | GOXHABASHI | 2917 | 16/48 | 131.00 | 700.0 | 91,700.00 |
| RUDOLF | VANGJEL | ZAHARIA | | | | | |
| ARSINO | AGATHOKLI | XHITOMI | | | | | |
| MARIA | AGATHOKLI | XHITOMI | | | | | |
| KISHA ORTHODOKSE | | | 8512 | 25/31 | 691.00 | 24,000.0 | 16,584,000.00 |
| TRASHEGIMTARET PEPA | | | 8250 | 4/173 | 30.60 | | 1,304,202.60 |
| KRYEGJYSHATA BOTERORE | | | 8180 | 6/258 | 12.10 | | 278,251.60 |
| VASIL | | JOVANI | 8220 | 5/272 | 220.00 | | 5,893,140.00 |
| TRASHEGIMTARET PEPA | | | 8250 | 4/173 | 30.60 | | 134,202.60 |
| B. P. XHAMETA | | | 8230 | 5/293 | 10.20 | | 211,313.40 |
| PELLUMB | | MEHMETI | 8230 | 5/291 | 44.65 | | 925,014.05 |
| B. P. BUDA | | | 8260 | 4/436 | 30.30 | | 964,994.40 |
| ORNELA | DILAVER | ABAZI | 3866(8220) | 315/154 | 498.20 | | 14,277,913.80 |
| HASAN | | HAMETAJ | 8270 | 6/365 | 14.50 | | 461,796.00 |
| KRISTINA | | HAMETAJ | | | | | |
| REXHEP | ELMAZ | DUSHKU | 8523 | 9/64 | 945.40 | | 16,544,500.00 |
| ARGJENTINA | ADEM | BIMBASHI | | | | | |
| MAKBULE | NGJATI | BIMBASHI | | | | | |
| DASHAMIRA | NGJATI | BIMBASHI | 8523 | 18/113 | 519.70 | | 4,677,300.00 |
| XHAVIT | NGJATI | BIMBASHI | | | | | |
| AFERDITA | NGJATI | BIMBASHI | | | | | |
| EJUP | IBRAHIM | KRASNIQI | 8523 | 34/89 | 599.20 | | 5,392,800.00 |
| NAFERIT | | DELIMETA | 8522 | 6/190 | 23.90 | | 358,500.00 |
| REVOLUCION | SHUAIP | ÇEKREZI | 8522 | 16/431 | 298.30 | | 2,893,000.00 |
| JAKUP | | KANA | | | | | |
| ISUF | JAKUP | KANA | | | | | |
| NURIE | | KANA | | | | | |
| SANIE | JAKUP | KANA | | | | | |
| MYZEJEN | JAKUP | KANA | 8523 | 5/190 | 64.70 | | 1,132,250.00 |
| ARTAN | JAKUP | KANA | | | | | |
| QEMAL | BEHEXHET | KANA | | | | | |
| XHEVAHIR | BEHEXHET | KANA | | | | | |
| HYQMET | BEHEXHET | KANA | | | | | |
| BALLKEZ | | KANA | | | | | |
| TASIM | | BISHQEMI | | | | | |
| QAMIL | | BISHQEMI | 8523 | 8/109 | 41.10 | | 719,250.00 |
| SHEFQET | | BISHQEMI | | | | | |
| XHEMALI | | ÇERMA | 8522 | 13/171 | 71.10 | | 497,700.00 |
| DHE TRASHEGIMTARET | | | | | | | |
| PASKAL | | QIRJAQI | 1594 | 6/161 | 6.00 | | 3,900.00 |
| LLAZI | GAQI | RIZA | | | | | |
| THEMISTOKLI | NISI | RIZA | | | | | |
| DHIMITRAQ | NISI | RIZA | | | | | |
| THEODHORAQ | NISI | RIZA | | | | | |
| NIKOLLA | NISI | RIZA | | | | | |
| PANDELI | RAFAIL | RIZA | 1403 | 171/27 | 540.00 | | 1,393,740.00 |
| MIRSA | RAFAIL | RIZA | | | | | |
| LIGORAQ | RAFAIL | RIZA | | | | | |
| FRIFILI | DHIMITER | RIZA | | | | | |
| LEDINA | JANI | RIZA | | | | | |
| ERJANA | JANI | RIZA | | | | | |

*(Vijon nesër)*

Opinioni i Ditës

# Taksë apo tarifë?

Nga Fatos Çoçoli

*(Vijon nga faqja e parë)*

... dhe i afrohesh Shkupit, autostrada që të çon në të ka sportele ku paguan tarifën e saj. E njëjta gjë ndodh me autostradën pranë Podgoricës në Mal të Zi, si dhe me autostradat në Greqi. Pagesa e një rruge nuk mund të jetë taksë, pse taksa është një detyrim ndaj shtetit që e paguajmë të gjithë (për shembull taksën mbi televizionin publik), pavarësisht se sa e përdorim atë shërbim për të cilin paguhet taksa. Taksat janë detyrimet tona për të mbajtur shtetin nuk e kanë të qartë dallimin e taksës nga tarifa, por një drejtuesi të pushtetit vendor nuk i falet të mos e dijë. Kryebashkiaku i Kukësit foli se është dakord që të paguhen taksat. Duke menduar se taksë është edhe kjo që iu vu Rrugës së Kombit. Në fakt, është vetëm pagesë për mirëmbajtjen dhe përfundimin e saj. Ajo rrugë duhet të paguhet. Buxheti i Shtetit ka paguar mbi 1 miliard euro për të deri tani. Nuk mund të lëshojë para më tepër. Rruga është ndërtuar shumë keq, ka nevojë urgjente për t'u mbaruar dhe mirëmbajtur. Mirëmbajtja duhej dhënë që në fillim me koncesion dhe rruga të tarifohej që pas mosdoshmëri, që Buxheti i Shtetit të mos rëndohet sërish deri në rrënim. Kjo qeveri që kemi tani gaboi kur nuk foli qartë përpara qytetarëve të vet për përmbajtjen e kontratës koncesionare. Për faktin se ata që e përdorin më shumë gjatë një viti rrugën (janë banorët e qytetit të Kukësit dhe të fshatrave të këtij qarku) do të pajisen brenda 6 muajve me abone, duke paguar për çdo kalim shumë më pak. Madje t'u mëtonte njerëzve edhe se sa më pak do të paguanin kuksianët. Nuk e bëri këtë gjë si duhet ose fare dhe në protestë dolën shumë qytetarë të Kukësit e banorë të fshatrave përjep. Shume prej tyre, të dhëna gjatë këtyre 11 viteve të fundit, kanë një të kaluar të errët dhe shumë problematike. Partneritetet Publik-Privat, një formë e re koncesioni për ne, kanë filluar të rëndojnë Buxhetin e Shtetit me pagesat vjetore të tyre. Për vitin 2017 paguam si shtet 56 milionë euro. Është pagesa e interesit sikur të kemi marrë borxh për 10 vjet një shumë prej një miliard euro! Këtë vit do të paguajmë edhe më shumë, 70 milionë euro.

Çdo vit kjo faturë do të bëhet gjithnjë e më e kripur dhe e rëndë, sa herë që shtohen koncesionet ku paguan edhe shteti, apo Partner-




në këmbë, që ai të na kryejë shërbime që privati nuk mund të na i kryejë. Kështu që, sado orekse politike dhe partiake mund të ngrihen dhe sillen rreth pagesës për Rrugën e Kombit, ajo është thjesht dhe vetëm një tarifë. Do të vilet për të siguruar mirëmbajtjen e një rruge jashtëzakonisht të kushtueshme, e cila për 8 vjet, që kur hyri në funksionim, as nuk është mirëmbajtur, as nuk është përfunduar tërësisht.

Sot rrezikon të shembet në shumë pjesë të saj, së bashku edhe me një urë! Shumë prej nesh ende inaugurimit të pjesës më të vështirë të saj (aksit Rrëshen-Kalimash) në janar 2010. Ajo rrugë shkurton shumë kohë, karburant dhe amortizim makine dhe është e drejtë të paguhet për përdorimin e saj. Po të ishte vendosur tarifa që në fillim, askush nuk do të kishte kundërshtuar dhe nuk do të ishte ndjerë keq sot. Por kjo nuk u bë. U gabua nga të dyja qeveritë e periudhës 2010-2017. Qeveritë e viteve 2009-2013 dhe 2013-2017 nuk guxuan ta bënin, për shkak të kostos zgjedhore të kësaj mase.

Por tarifimi i rrugës është doreth me të ardhura modeste ose të pakta. Që janë shqetësuar me plot të drejtë.

Kjo dalje u dha krahë atyre që kërkonin vetëm turbullira, për të shkatërruar dhe djegur sportelet e pagesës së rrugës. Në lojë është dinjiteti i shtetit, jo vetëm i qeverisë. Për të mos pasur shkatërrime dhe djegie të tjera, qeveria bëri mirë që mori 2 muaj kohë, për t'u shpjeguar qytetarëve të saj, sidomos kuksianëve, abonetë e kontratës koncesionare. Qeveria bën mirë të vërë mend me transparencën e plotë për koncesionet që itetet Publik-Privat. Qytetarët e këtij vendi kanë të drejtë të dinë se ç'po luhet përtej fasadës dhe fjalëve të bukura për shërbimet mjekësore falas, apo për rrugët dhe shkollat që do të na i ndërtojë privati me formulën që duket magjike "Partneritetet Publik-Privat". Qeveria bën mirë ta nisë transparencën e plotë jo vetëm për Rrugën e Kombit në këto 60 ditë që i ka vendosur vetes, por për të gjitha Partneritetet Publik-Privat, që mendon të japë për programin 1 miliard euro të investimeve publike për këtë vit.




## HOROSKOPI

### DASHI

Planetet kërkojnë të krijojë dyshime për ato që jeni të sigurt, por nuk do t'ia dalin. Do të reagoni me vendosmëri gjatë një momenti pasigurie. Do të tundoheni t'i tërhiqni përsëri vëmendjen një personi të dashur, por më pas do të hiqni dorë për shkak të sedrës.

### DEMI

Me Plutonin kundra mund t'ju hynë dyshimet dhe druajtja për të hyrë në lojë. Mos kini frikë të ndiqni rrugën që ju thotë zemra. Vazhdoni ta mbani nën kontroll bilancin tuaj ekonomik. Priten shpenzime, madje edhe të papritura.

### BINJAKET

Dëshira për të përfituar nga mundësitë e mira të dhuruara nga Mërkuri dhe Venusi, që i buzëqeshin Hënës, do të bëjë që projektet t'ju dalin me sukses. Prandaj jepini punës. Sot do të jeni në humor të mirë, do të keni dëshirë të qëndroni afër dhe të ndihmoni njerëzit.

### GAFORJA

Nëse arrini ta kapni në ajër mundësinë, do të keni fatin të punoni krah për krah me persona të një niveli të lartë nga të cilët mund të mësoni shumë. Mos harroni ata që ju kanë treguar dashuri, për të ndjekur ëndrrat e lavdisë.

### LUANI

Gjatë ditës, në punë do t'ju kërkohet të bëni një sakrificë të vogël që nuk do ta prisni me buzëqeshje. Duroni! Ndërkaq, Urani mik është gjithmonë i vëmendshëm për t'ju shpëtuar nga çdo pengesë që ju del gjatë rrugës së punës. Do të arrini të shënoni suksese.

### VIRGJERESHA

Qëndroni afër një bashkëpunëtori që ka zakon të flasë pak si shumë. Ka rrezik që të përhapë fjalë jo shumë të mira për ju. Mund t'i kërkoni këshillë kujt të doni, pos mos lejoni të ndikoheni për zgjedhje që kanë të bëjnë me fushën e dashurisë.

### PESHORJA

Me Plutonin dashamirës dhe ogurmirë, nuk është me koha t'i lini gjërat për më vonë. Shikoni thellë brenda vetes dhe përballuni me sqarimet e nevojshme me partnerin. Dëshira e juaj për të jetuar i lirë do të gjejë mbështetje tek një mik i dashur.

### AKREPI

Ditën e sotme mos kërkoni zgjidhjen më të thjeshtë për të ta bërë punën më të lehtë. Kështu rrezikoni të mbeteni pa gjë! Mos e ekzagjeroni me kritika, nëse një koleg nuk ka qenë në lartësinë e duhur të pritshmërive. Vlen më mirë të përpiqeni për ta ndihmuar.

### SHIGJETARI

Një projekt i çuar përpara me zgjuarsi do të japë rezultatin e pritur. Nuk ju mbetet veçse të vazhdoni përpara me personat që keni zgjedhur në veprimtarinë e ndërmarrë. Ditën e sotme bëni gjithçka që të mos lëndoni ata persona që i doni vërtet.

### BRICJAPI

Keni një këndvështrim të idealizuar të raportit në çift. Por kujdes, duke zgjedhur një dashuri të pamundur, mund të harroni për gjërat e bukura që keni pranë vetes. Do të keni shumë ide, madje edhe aftësinë praktike për t'i zbatuar ato.

### UJORI

Jupiteri në qiellin tuaj i buzëqesh Hënës dhe Diellit. Sot do të jeni optimist dhe do t'ia dilni të merrni çdo gjë që doni me angazhim minimal. Potenciali krijues është në nivelet më të larta.

### PESHQIT

Fronti i dashurisë, me Venusin armiqësore, do të jetë pak i dobësuar. Shumë mendime, shumë ftohtësi, shumë vetëkontroll, shumë të larguar. Nëse do të arrini të ndërthurni fantazinë me sensin praktik, do të arrini një qëllim që ia keni vënë syrin shumë kohë përpara.

Opinioni i Ditës

# Tri modele në gjashtë realitete politike

Nga dr. Jorgji Kote

*(Vijon nga faqja e parë)*



... dhe tensionimi publik-institucional i muajve të fundit midis indipendentistëve katalanas dhe Madridit janë të lidhura ngushtë me riformatizimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve tërësore afatgjata. Sipas shumë ekspertëve, këtij synimi madhor i shërben dhe referimi te disa modele politike të njohura. Falë suksesit të tyre emblematik, studimi pse jo dhe "kopjimi" i tyre përbën "Must" ose domosdoshmëri jetike në këtë drejtim. Me kujdes për të mos e kthyer qëllim në vetvete e ca më pak si "ilaç magjik" referimi te këto modele u pret rrugën eksperimenteve boshe dhe "ecjes në shtigje të pashkelura".

Le ta ilustrojmë këtë proces, me të mirat, të metat dhe specifikat e tij nëpërmjet një analize të thjeshtë krahasuese të tri modeleve të mëparshme të suksesshme, veçse tashmë në gjashtë realitete e reja gjeopolitike, që u përmendën në fillim të këtij shkrimi.

Në vitin 1988, ish-presidenti koreano-jugor Roh Tae Woo shpalli "Nord Politik" si version të "Ostpolitik" të famshme gjermane. 10 vjet më vonë, pasardhësi i tij e riemërtoi atë "Sunshine Policy" ose "Politika Diellore".

Por, ndërsa "Ostpolitik" i dha frytet e veta me ribashkimin e Berlinit, Gjermanisë dhe Evropës, "dielli koreano-jugor" jo vetëm nuk u ngjit dot në atë stekë, por as nuk mundi të shkrinte akujt e "Luftës së Ftohtë".

"Politika Diellore" dështoi, sepse ndryshe nga "Ostpolitik", ajo nuk pati mbështetjen e SHBA-ve dhe Japonisë. Këto dy të fundit i mëshonin pothuajse tërësisht presionit me përdorimin e forcës ushtarake, ndërsa Koreja e Jugut afrimit dhe bashkëpunimit sipas parimit "armikut jepi dhurata që të mos të të bëjë keq". Kurse tani që SHBA-të u futën në lojë në nivelin më të lartë së bashku me Korenë e Jugut dhe Japoninë, ky proces do të fuqizohet ndjeshëm dhe do të jetë shumë më efektiv.

Ndryshe nga "Ostpolitik" për të cilën Evropa & SHBA akorduan ndihma të mëdha financiare dhe materiale në miliarda dollarë, por të kushtëzuara këto qartë me zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut etj., "Politika Diellore" u tregua tejet bujare, por pa këtë kushtëzim politik ndaj Koresë së Veriut.

Më tej, "Ostpolitika" koreane u zbatua kur në Phenian nuk kishte opozitë dhe as disidencë, ndryshe nga "Ostpolitika" gjermane, e cila u mbështet edhe në oponencën ekzistuese, sidomos në Poloni, Çekosllovaki dhe Hungari, si premisë kryesore për ndryshimin e regjimeve totalitare atje.

Gjithashtu, ndryshe nga "Ostpolitik", "dielli" koreano-jugor nuk arriti të "ngrohte" dhe të shkonte te publiku i gjerë, media, arti dhe kultura, sidomos në Korenë e Veriut. Për pasojë, Seuli nuk u bë dot një "vitrinë e vërtetë" e demokracisë dhe begatisë për Korenë e Veriut, si Berlini Perëndimor.

Shto këtu dhe rrezikshmërinë shumë më të madhe të Koresë së Veriut, për shkak të zotërimit të arsenalit bërthamor dhe kjo tablo bëhet edhe më e zymtë. Për më tepër, aleatët koreano-veriorë, Kina dhe Rusia janë sot shumë më të fuqishme politikisht dhe ushtarakisht se në vitet '70-'80.

Ja pse po forcohet bindja se duke shmangur anët negative dhe duke e përditësuar/pasuruar me elementë të tjerë, "Ostpolitika" mund të kthehet sërish në një histori suksesi edhe në Gadishullin Korean, veçse duke kombinuar "fuqinë e butë dhe të ashpër" ose "kulaçin dhe kërbaçin".

Pajtimi franko-gjerman si model emblematik u realizua fill pas Luftës së II Botërore nga dy vende ish- armiq tradicionalë, që shkaktuan dy kasaphana botërore dhe 25 luftëra të tjera rajonale. Në dallim nga vendet e rajonit tonë, kishin avantazhin e madh si dy popuj me vlera, tradita dhe histori, me shkallë të lartë emancipimi demokratik, me kapacitete të jashtëzakonshme ekonomike, financiare dhe institucionale, që brenda vetëm 10 viteve rekord riparuan shkatërrimet e luftës dhe u renditën ndër 7 vendet më të zhvilluara të botës.

Pajtimi franko-gjerman vërtet filloi nga lart- poshtë, pra nga politika, por pastaj u nxit dhe u shoqërua dhe nga poshtë-lart, duke u bërë "pronë" e të gjithëve. Ky proces është konkretizuar në qindra forume dhe takime franko-gjermane, aktivitete ekonomike, artistike, sportive, shkencore, mbledhje qeverie, madje edhe përfaqësim i përbashkët në shumë raste në forumet më të mëdha botërore etj. Ai u institucionalizua në Traktatin e famshëm të Elizesë më 25 janar 1963. Kurse disa javë më parë, Merkel dhe Makron mbi bazën e dinamikës së tij pozitive 55- vjeçare pritet të nënshkruajnë një Traktat të ri në fund të këtij viti, me përmbajtje të njëjtë, por duke e pasuruar me kërkesa dhe komponentë të tjerë jetikë.

Krahas aspektit politik, ekonomik, kulturor etj., për realizimin e këtij procesi, veç Planit amerikan Marshall, më vonë u vunë në përdorim fonde të kolosale financiare nga të dy këto vende; një dallim ky "si nata me ditën" me vendet e rajonit tonë, që me gjithë dëshirën, nismat dhe mbështetjen ndërkombëtare nuk i kanë kapacitetet financiare për realizimin qoftë edhe të disa prej këtyre projekteve pajtuese me emra tingëllues. Për pasojë, shumë prej tyre mbeten në letër dhe premtime mediatike të çastit.

Aktorë tejet të rëndësishëm në pajtimin franko-gjerman kanë qenë dhe mbeten artistët elitarë. Kështu, pesë dekada më parë, gjermania mitike Romy Schneider rroku zemrat e francezëve me lojën e saj me Alain Delon; yjet e këngës franceze, Mirelle Matieux dhe Patricia Kaas janë po aq të preferuara në Gjermani sa dhe në Francë; legjenda franceze e shekullit Charles Aznavour e festoi 90-vjetorin e tij me një turne artistik në Gjermani e kështu me radhë.

Ndërsa në Ballkan, roli dhe dimensioni i artit dhe kulturës me përjashtime të pakta është tepër i vogël. Me gjithë disa hapave pozitive edhe në fushën e shtypit, medias, shkollës, librit etj., ka shumë rezerva dhe mundësi.

Për pasojë, në rajonin tonë e sidomos ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, pa mohuar e nënvleftësuar hapat/demarshet e shumta gjatë 20 viteve të fundit, me ndërmjetësimin e SHBA-ve dhe BE-së, plus ndihmesën e madhe të Procesit të Berlinit këto pesë vitet e fundit, ndonëse nuk lihet rast pa përmendur këtë model, pak është bërë për krijimin nga poshtë-lart të klimës, mjedisit dhe terrenit të nevojshëm për këtë pajtim. Kështu, nëse Strasburgu si nyja nevralgjike e ballafaqimit të ashpër, u kthye brenda 5 viteve si ura gjigante e pajtimit franko-gjerman, ura e Mitrovicës vazhdon të mbetet një mur të madh pengues.

Pa mohuar "gjynahet" e të tjerëve, përgjegjësinë në këtë mes e ka politika serbe; në vend që të ndihmojë me mundësitë e saj më të mëdha, edhe pse ka pesë vjet e angazhuar në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja me Kosovën, politika serbe shquhet shumë më tepër për sjellje, qëndrime dhe një gjuhë primitive që bien ndesh dhe janë shumë larg modelit franko-gjerman dhe frymës evropiane. Kështu, ditën e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, emisarët serbë deshën të "prishin" atmosferën festive me "fake news" se gjoja aksh shteti kishte tërhequr njohjen e saj! Apo kur në mënyrë demonstrative, Serbia shpreh mirënjohjen ndaj një vendi, që nuk e ka njohur Kosovën apo kur kërkojnë "ndërmjetësimin" e ndonjë vendi të tretë, që nuk e ka njohur as vetë Kosovën e plot raste të tjera më të rënda të njohura.

Dihet se pajtimi historik franko-gjerman çoi në themelimin e BE-së në vitin 1957, me këto dy vende ndër 6 themelueset e para dhe boshti i funksionimit të saj. Kurse në Serbi, mbi pesë vjet pas fillimit të dialogut me Kosovën po ndodh e kundërta; atje qarqet politike dhe antievropiane janë gati të sakrifikojnë anëtarësimin në BE vetëm që të mos njohin Kosovën! Dhe së fundi, nëse në modelet e tjera ka mundësi "kopjimi" natyrisht me përshtatjet e duhura, referimi/krahasimi ndërmjet Pavarësisë së Kosovës dhe pretendimeve të separatistëve katalanas për shkëputje nga Spanja është jashtë çdo logjike juridike dhe praktike. Siç është dëshmuar bindshëm nga shumë ekspertë dhe instanca të së drejtës ndërkombëtare, Kosova përbën një rast "sui generis", që nuk ka fare lidhje me Katalonjën dhe me konfliktet e tjera "të ngrira". Mjafton të përmendet se Katalonja ka dekada që jeton dhe lulëzon ekonomikisht në një shtet demokratik, anëtar i BE-së dhe NATO-s si Spanja, ku në mbi katër dekada të demokracisë nuk i është nënshtruar kurrfarë persekutimi dhe përjashtimi si Kosova thundrën serbe; atje nuk ka pasur një tiran si Millosheviçi dhe klika e tij, që shtypi dhe gjakosi Kosovën. Kjo e fundit, edhe pse ishte pjesë e Ish-Federatës Jugosllave, jetonte në kushte të mjerueshme social-ekonomike, kurse Katalonja renditet në rajonet më të zhvilluara të botës.

Së fundi dhe më e rëndësishmja, pavarësia e Kosovës dhe e ardhmja e saj evropiane u përkrah qysh në fillim dhe ka 10 vjet që mbështetet fuqimisht nga OKB, BE, NATO, SHBA dhe partnerë të tjerë të mëdhenj ndërkombëtarë; ajo është njohur nga 116 vende dhe shumë organizata të tjera ndërkombëtare, ndërsa idenë e pavarësisë së Katalonjës nuk po e njeh kurrkush, sepse ajo konsiderohet me të drejtë çështje e brendshme e Spanjës.

Në fakt, siç është shpjeguar hollësisht në shkrimin e kësaj gazete "Katalonja Spanjolle dhe Flandra Belge" modeli më i përshtatshëm për Katalonjën mund të ishte Rajoni i Flandrës në Belgjikë, i cili është me kompetenca shumë të mëdha e të zgjeruara dhe autonomi maksimale nga pushteti qendror.

NJË KAFE NË DURRËS



## Pasi konfirmoi Skënderbeun në superiore, Duka takohet me Takajn

"Skënderbeu është dënuar njëherë dhe nuk mund ta dënojmë prapë", kjo frazë e thënë nga presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit ka sjellë qetësinë te kampi bardhekuq, por pështjellime te rivalët. Rastet analoge në Europë tregojnë se federatat kanë marrë masa drastike ndaj klubeve të gjetura fajtore në trukim. Gjithsesi, kreu i federatës nuk kërkon ta rëndojë edhe më situatën e skuadrës korçare, madje i ka dhënë mbështetjen e tij personale. Madje më tej se kaq, kreu i FSHF-së, që po përballet së fundmi me luftën e ish-kandidatit Bashkim Fino në zgjedhjet presidenciale, është fotografuar ditën e hënë në mbrëmje vonë në një nga lokalet e qytetit të Durrësit në shoqërinë e Ardjan Takajt. Presidenti i Skënderbeut dhe Duka kanë konsumuar së bashku një kafe dhe tema e bisedës mendohet të ketë qenë pikërisht situata e klubit korçar, që ka përfunduar në syrin e ciklonit i akuzuar për trukimin e 53 ndeshjeve në veprimtari të ndryshme si Kupat e Europës, Kategoria Superiore apo edhe takime miqësore. Megjithatë në dosjen e fundit UEFA ishte përqendruar në vetëm 4 ndeshje të Ligës së Europës, ndërsa beteja e radhës mes palëve do të zhvillohet në KAS.

### Kristiano Ronaldo shkëlqen me dy gola duke udhëhequr të tijtë në fitoren 3-0 në Torino

# Reali turpëron Juventusin Bajerni fiton të parën

## *Bavarezët pësojnë të parët, por përmbysin gjithçka*



Jeton Selimi

Kristiano Ronaldo i ka siguruar Real Madrid kualifikimin në gjysmëfinalet e Ligës së Kampioneve. Edhe pse mbetet ende ndeshja e kthimit për t'u luajtur kundër Juventusit, rezultati i duelit të parë e bën thuajse formalitet duelin në "Santiago Bernabeu". Ronaldo tregoi përsëri se është i pandalshëm në Ligën e Kampioneve e aq më shumë përballë Juventusit, duke shënuar në portën e Bufon që me rastin e parë që iu shfaq, në minutën e 3-të të ndeshjes, për atë që ishte goli i tij më i shpejtë në karrierë në këtë turne. Pas avantazhit, Reali i lëshoi terren Juventusit që provoi në të gjitha mënyrat të shënonte, por pa sukses. Ndërsa madrilenët iu afruan golit të dytë me traversën e goditur nga Kros me një "predhë" nga jashtë zonës. Në pjesën e dytë, ishte përsëri Juventusi që diktoi ritmin, por më pas u desh të dorëzohej përballë një tjetër mrekullie të Ronaldos. Pas një aksioni të madrilenëve, të cilët gjetën në gjumë mbrojtjen vendase, Ronaldo shënoi me një roveshatë spektakolare, që bëri të çoheshin në këmbë edhe tifozët juventinë për ta duartrokitur. Në minutën e 66-të, shanset e Juventusit për të përmbysur ndeshjen shkuan në zero, pasi Dibala mori kartonin e dytë të verdhë, për të lënë ekipin e tij me 10 lojtarë. Vetëm 6 minuta më vonë erdhi edhe goli i tretë i Realit, këtë herë me Ronaldon që dha një asist të artë për Marcelon, i cili mposhti Bufon për të vulosur rezultatin që nuk ndryshoi më, edhe pse madrilenët iu afruan disa herë golit të katërt përballë Juventusit që thjesht priste vërshëllimën përfundimtare.



**CHAMPIONS**

| TË MARTËN | |
|---|---|
| Juventus - Real Madrid | 0-3 |
| Sevilja - Bajern Mynih | 1-2 |
| **TË MËRKURËN** | |
| Barcelona - Roma | 20:45 |
| Liverpul - Mançester Siti | 20:45 |

Bajern Mynih ka hedhur një hap të sigurt drejt gjysmëfinaleve të Ligës së Kampioneve pasi ka marrë një fitore në transfertë në takimin përballë Seviljes. Por skuadra e Jup Hejnkes ka djersitur jo pak në këtë transfertë në Spanjë dhe do të duhet të tregohet e kujdesshme në duelin e kthimit. Në fakt, ekipi i drejtuar nga Vinçenco Montela ka dhuruar një lojë shumë cilësore dhe ka krijuar mjaft raste të mira shënimi në këtë ndeshje, duke arritur edhe të gjente i pari rrjetën me anë të Sarabia, pasi kishte kaluar gjysmë ore lojë. Por Bajerni gjeti shumë shpejt barazimin falë një devijimi fatkeq të Navas ndaj goditjes së Riberi, duke bërë që pjesa e parë të mbyllej në barazimin 1-1.

REKORD I RI



## Derbi kinez i Milanos do arkëtojë 4 mln euro nga biletat

Derbi i prapambetur i kampionatit italian, ai mes Milanit dhe Interit, nuk e ka humbur aspak interesimin e madh të tifozëve, pavarësisht se duhej të ishte luajtur kohë më parë. Përkundrazi, ky takim do të vendosë një rekord të ri sa i përket tifozëve në shkallët e stadiumit dhe të ardhurave të mbledhura nga kjo sfidë. Një rekord i ri është vendosur sa i përket të ardhurave në këtë sfidë, pasi në stadium do të jenë 75.000 spektatorë dhe përafërsisht janë grumbulluar rreth 4.1 milionë euro. Në këtë mënyrë do të thyhet rekordi i derbit të 2016 që është luajtur në 20 nëntor, mes këtyre dy ekipeve, teksa u grumbulluan rreth 3.8 milionë euro. Takimi është përcaktuar të luhet në orën 18:30 dhe nuk do të ketë konkurrencën e "Champions League", megjithatë në një takim të këtij niveli, të humbur mund të dilnin edhe ndeshjet e evenimentit më të ndjekur në Europë, nëse do të kishte përplasje oraresh.

### Kandidati për kreun e FSHF-së

## Fino hedh poshtë Dukën: Nuk jam tërhequr nga KAS-i

Rivali kryesor në zgjedhjet e fundit të Federatës Shqiptare të Futbollit për Armando Dukën, ishte deputeti Bashkim Fino. Menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, Fino u shpreh se do e ndiqte çështjen deri në organizmat më të larta, pasi kishte hasur paligjshmëri në ato zgjedhje. Një nga ngjarjet e komentuara të ditëve të fundit, ishte edhe vendimi i gjykatës së Tiranës, që vendosi të mos regjistronte Armando Dukën si president të FSHF-së, ndërsa ky i fundit u shpreh gjatë ditës së djeshme se Fino kishte pezulluar padinë në Gjykatën e Arbitrazhit. Në një prononcim për "Report Tv", Fino mohon të ketë tërhequr ankimimin në CAS: "Nuk është e vërtetë që jam tërhequr nga CAS. Pres vendimin e CAS-it të Lozanës, i vendosur që këtë çështje ta çoj deri në fund. Gjykata nuk i regjistroi zgjedhjet, drejtuesit e FSHF-së janë jolegjitime dhe zgjedhjet në FSHF-së do të ribëhen", është shprehur Bashkim Fino.



### Klubi grek do luajë me të rinjtë

## Presidenti shkrin Olimpiakosin: Nuk ma kishin fajin trajnerët

Vendim drastik i presidentit të Olimpiakosit, Evangelos Marinakis, i cili, pas barazimit të fundit në kampionat, ka vendosur ta shkrijë skuadrën. Ai u ka vendosur futbollistëve një gjobë 400 mijë eurosh dhe u ka komunikuar se të gjithë janë të lirë të shkojnë me pushime, pasi nuk do të jenë më pjesë e ekipit. Me sa duket, nuk paska pasur faj Besnik Hasi. Vetëm pak lojtarë do të qëndrojnë tek Olimpiakosi dhe pjesa tjetër do të plotësohet me lojtarë nga të rinjtë, ku mund të ketë edhe ndonjë shqiptar. Lajmi ka bërë bujë dhe është pasqyruar edhe nga prestigjiozja angleze "Daily Mail", që citon edhe fjalët e presidentit Marinakis: "Largohuni që sot, mjaft ju kam duruar. E keni mendjen për shtëpitë dhe makinat e bukura, ndërsa unë paguaj miliona. Kam ndërruar tre trajnerë, por e kuptoj që është faji juaj", - u është drejtuar lojtarëve presidenti i Olimpiakosit, i xhindosur pas barazimit me Levadhjakosin, që e mban skuadrën e tij larg kreut plot 9 pikë.




www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
Sherri për kafshët, Roza Lati: Do t'i jap kastravecë
BLUE TOOTH
500 NUMRA, NJE HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!